

E përmuajshme kulturore dhe informative

nr. 6, viti 1, dhjetor 2007

Revista **Studenti**

Revistë elektronike e studentëve kosovarë në Brunei

Haxhxi poliester i qetësisë
Dhuna moderne mbi femrat
Kosova në udhëkryq
Imam Ahmed ibn Hanbeli

Përmbajtja:

Fq. 2 -Përmbajtja
Fq. 3 -Editorial



Fq. 29 -Uebi i së ardhmes



Fq. 4 -Mësuesja britaneze fyen profetin Muhammed



Fq. 30 -Komentimi i sures En-Nebee



Fq. 5 -Haxhxi poli-ester i qetësisë



Fq. 32 -Zbatimi i Kur'anit...



Fq. 9 -Njohuri mbi shkencën e feve komparative



Fq. 35 -Nuk je ti i verbër...



Fq. 12 -Imam Hanbeli

Fq. 14 -Edhe ne jemi pjesë e botës...



Fq. 38 -I kthyeri nga Guantanamo



Fq. 16 -Dhuna modern mbi femrat

Fq. 19 -Kosova në udhëkryq



Fq. 41 -E kam ditur që do të vish



Fq. 21 -Si t'i shërbejmë islamit

Fq. 22 -Dialog me qiriun



Fq. 42 -Lajme shkurt



Fq. 43 -Studim


Fq. 44 -Pervjetor



Fq. 24 -Mbyllni gjyqet e inspektiveve
Fq. 25 -Thirrje për n'xhennet



Fq. 45 -Kërkim ne horizont



Fq. 46 -Kështu fliste Hasan el-Basriu

Fq. 47 -Kuriozitete




Fq. 27 Problemet familjare....



Fq. 48 -Argëtim

Fq. 49 -Letrat e lexuesve





“Për hir të All-llahut, vizita e shtëpisë (Qabes) është obligim për atë që ka mundësi udhëtimi te ajo...”

Editorial



Vizita e shtëpisë së shenjtë

Nga vendet e ndryshme të botës, njerëz të të gjitha shtresave dhe moshave ia mësyjnë vendit të shenjtë, Qabes, duke pasur për qëllim kryerjen e një dispozite të Islamit, respektivisht obligimin e haxhxit.

Në vendtubimin e haxhilerëve në Qabe, në vendin ku gjithë muslimanët nga anembanë bota drejtohen drejt tij gjatë lutjeve të tyre, tubohen miliona njerëz në kongresin vjetor të muslimanëve, të gjithë të veshur në petk të bardhë, qëndrojnë të përulur para Krijuesit të vetëm, me një kënaqësi shpirtërore ata kujtojnë me nostalgji çastet e Profetit Ibrahim kur deshi të sakrifikoi të birin e tij në shenjë miratimi ndaj urdhrit të Zotit, kujtojnë luginën e dikurshme të Mekkes ku Haxherja vraponte në të në shenjë kërkimi të ujit dhe kalimtarëve. Ata meditojnë rreth shtëpisë së parë të adhurimit, e ngritur në tokë, kujtojnë vendlindjen e Profetit Muhammed a.s., mendojnë rreth sprovave dhe vështirësive të tij, dhe të gëzuar rikujtojnë triumfin historik dhe ngadhënjimin heroik të tij.

Ata të mallëngjyer meditojnë në ditën kur shtëpia e shenjtë-Qabeja, u pastrua nga idolatritë e ndryshme tërësisht të pa vlera, dhe iu rikthye edhe një herë adhurimit të të vetmit Allah. Në vendin më të bekuar, ata i luten vazhdimisht Krijuesit të tyre, lutjet e tyre nuk ndalen për asnjë çast dhe moment, në fytyrat e tyre shihet qartë gëzimi, sytë e tyre shpeshherë i përshkon loti kur shohin bukuritë mahnitëse të Qabes së shenjtë.

Me një përkushtim të plotë disa ditësh ata praktikojnë urdhrin Hyjnor dhe shkelin gjurmëve të traditës Profetike duke emituar atë hap pas hapi, këtë rrugëtim të shenjtë dhe madhështor ata e përmbyllin me festën e Kurban Bajramit. Andaj, për haxhixin e pranuar nuk ka shpërblim tjetër përpos Xhennetit-thoshte kështu Profeti Muhammed a.s.!

REVISTA STUDENTI

KRYEREDAKTOR:

Ejup Haziri

REDAKSIA:

Bekim Hasani
Feim Dragusha
Berat Hashani
Ardian Sejdiu
Ejup Haziri

KORREKTOR:

Merita Preteni

Adresa:

Jalan Tungku Link Gadong
BE 1410, University of Brunei
Darussalam.

E-mail:

studenti_brunei@hotmail.com
brunei_student@hotmail.com

Dizajni: Ejup Haziri

Kryeredaktori

NË SHËNJESTËR

MËSUESJA BRITANEZE FYEN PROFETIN MUHAMMED A.S.

Ejup Haziri

Kohëve të fundit, fyerjet dhe përcëimet ndaj vlerave të shenjta të muslimanëve po përsëriten shumë shpesh, sa që ende pa u harruar një ndodhi pason tjetra, shumica e këtyre fyerjeve po lansohen në perëndim apo në vende tjera nga perëndimorët. Edhe kësaj radhe protagonist i fyerjeve është krijesa më e çmuar në mbarë rruzullin e tokës, profeti Muhammed [paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të].

Mësuesja britaneze, Gillian Gibons (54 vjeçare) në një shkollë në kryeqytet të Sudanit, fyen profetin Muhammed, ajo e



Mësuesja Gillian Gibons

kishte emëruar një lodër në formë të ariut me emrin e Profetit Muhammed.

Një punëtor nga shkolla në të cilën Gibons ushtronte detyrën e mësimeve kishte lajmëruar organet përkatëse, dhe menjëherë rasti u paraqit në polici, e pastaj edhe në gjykatë.

Vendimi i gjykatës

Gjykata sudaneze gjykoj ndaj mësueses Gillian Gibons me 15

ditë burgim dhe me largimin e saj nga Sudani, për shkak të fyerjeve që ajo i kishte bërë profetit Muhammed.

Ministria e Jashtme britanike kishte zhvilluar biseda të pandërprera me ambasadën sudaneze në Britani, duke insultuar vazhdimisht që mësuesja e tyre të mos dënohet, apo thënë ndryshe të mos praktikohet 'xhildi'-rrahja e saj me katërdhjetë shkopin, apo burgosja e saj me një vit të plotë heqje lirie.

Shkolla mbyllet

Shkolla në të cilën mësuesja nga Liverpooli i Anglisë kishte dhënë mësim është mbyllur, Qeveria e Sudanit ka ndërhyrë duke mbyllur shkollën e cila ka funksionuar që nga viti 1902, dhe njëherit njihet si një shkollë me eksperiencë të lartë.

Gazetat sudaneze raportojnë për organet e shkollës se kanë kërkuar falje menjëherë për këtë veprim të shëmtuar, duke shtuar se pas incidentit shkolla menjëherë kishte përjashtuar mësuesen në fjalë.

Fyerjet ndaj Profetit

kontinuitet i pandërprerë

Fyerjet ndaj Profetit Muhammed s'kanë të ndalura, të gjithë i kujtojmë fyerjet që gazeta daneze 'Jyllands-Posten' ia bëri Profetit me botimin e karikaturave, e më pas edhe gazetat tjera të botës kur ribotuan ato karikatura në faqet e tyre. Pati edhe raste tjera kur

protagonisti i shpalljes dhe bartjes së misionit të saj u fye në mënyrat më të këqija, e gjithë kjo ndodh me parandjenja të qëllimshme.

Skenarët e tyre përsëriten e ripërsëriten në vende të ndryshme me metoda të llojllojshme, duke mos kursyer asnjë vlerë islame, dhe e tëra kjo mbrohet në 'emër të lirisë së shtypit dhe të shprehurit', ky është civilizimi evropian kur sharjet, ofendimet dhe nënçmimet mbrohen nën justifikimin e lirisë së shprehurit. Ky është absurditeti i një arsytimi qesharak!

Nuk mund të jetë liri e të shprehurit kur i pafajshmi fyhet e sulmohet, e sidomos kur fyhen personalitete të larta sikur profeti Muhamed [paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të], që mbarë bota e njeh si personaliteti më i famshëm në shtresën e tokës, i cili tërë jetën e tij ia kushtoi misionit për të nxjerrë njerëzimin nga injoranca e pabesimit në dritën e besimit dhe ndërgjegjes së pastër.

Deri kur do të vazhdohet me fyerje, nënçmime dhe etiketime ndaj vlerave të shenjta islame?! Deri kur perëndimi do ta fyen profetin Muhammed, i cili botën e ktheu në të mbarë duke ia dhënë imazhin real të saj dhe eliminou të këqijat e përhapura?! Andaj, ata duhet t'i falënderohen atij që ndryshoi rrjedhën historike, e mos ta fyejnë atë që tërë jetën ia kushtoi njeriut dhe idealit të tij!

NE VIGJILJE TE HAXHXHIT

HAXHXHI POLIESTER I QETËSISË

Hamdi Nuhiju

“Islami ngritët mbi pesë (shtylla); kryesore në të dëshmuarit se nuk ka Zot tjetër, përveç All-llahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i All-llahut, në kryerjen e namazit, në dhënien e zekatit, në të vizituarit e Qab`es dhe në agjërimin e Ramazanit” Hadith Profetik.

Nga ky hadith i Pejgamberit a.s. ne vetëm se i mësuam konditat e Islamit se cilat janë ato, ndërsa në komentimin e pjesës mbi haxhxhin dijetarët e nderuar të po këtij libri që e kemi për referencë ndër të tjerash thonë:

“Fjala haxhxh do të thotë të mësyerit Shtëpisë së Shenjtë, Qab`es, në muajt e caktuar për haxhxh. Ata janë: Shevval, Dhul-ka`de dhe dhjetë ditët e para të Dhul-hixhes. Haxhxhi zbatohet duke i realizuar porositë e Muhammedit a.s. që i ka thënë në lidhje me haxhxhin. Haxhxhi është adhurim, i cili kryhet fizikisht dhe materialisht, nëpërmes të cilit arrihen dobi të shumta si për individin ashtu edhe për shoqërinë. Mbi të gjitha, haxhxhi është kongres i madh islam, i cili tubon të gjithë muslimanët nga mbarë bota. Në anën tjetër, është një moment shumë i volitshëm, i cili iu mundëson muslimanëve që të njoftohen mes veti me vëllezërit

e tyre të të gjitha vendeve të botës...”

Ky shpjegim kaq i mrekullueshëm neve veçse na jep të qartë konceptin e haxhxhit. Pra, haxhxhi ta mundëson o musliman që të ndjehesh i pavarur, por



njëkohësisht edhe i varur, të mundëson që të jesh i vetëm, por edhe me shoqërinë dhe gjithë muslimanët. Këtu e ndjen se je ai personi i duhur për thirrjen e All-llahut xh.sh. Mëson realitetin, jetën, identitetin, shfryrjen, hidhërimin, gëzimin... Të mundësohet që për të parën herë të mendosh me kokën tënde, të logjikosh dhe të venitesh rreth e përqark idesë se je mysafir, je me historinë, je ti historia... Por, jo gjithmonë kjo kuptohet në këtë mënyrë dhe me këtë qëllim. Ata që kaluan jetën dhe arritën të gjashtëdhjetat ata nuk janë më të aftë që të mendojnë dhe të veprojnë në këtë mënyrë, por, për disa haxhxhi është vetëm një simbol i

qetësisë para transferimit të tyre për në ahiret. Fatkeqësisht, ky koncept është i mbjellë tek popujt musliman, se në haxhxh shkojnë atëherë kur të arrijnë të gjashtëdhjetat dhe jo atëherë kur janë në formën më të mirë edhe për t'i kryer ritualet e rënda që kërkohen nga haxhiu edhe për të jetësuar porositë e haxhxhit në përgjithësi. Ringjallja e Islamit nëpër shumë vende islame sot vetëm se ka filluar që t'i jap tjetër pamje këtij fenomen i jo konstruktiv. Sot, në haxhxh shkojnë shumë të ri dhe të reja, bile disa muajin e mjaltit vendosin që ta kalojnë dhe përjetojnë në haxhxhin e tyre të parë në jetë.

Do theksuar se Haxhxhi është bërë obligim në vitin e dytë të hixhretit...

Ceremonitë e haxhxhit shkurtimeisht janë siç vijojnë:

- në kufi të territorit të shenjtë rreth Mekkes zhvishen teshat e rëndomta dhe të gjithë haxhilerët veshin dy copa të pëlhurës (ihram), uniformë e cila është e obligueshme vetëm për meshkujt, kryeshtruar, ata do mundohen ta harrojnë vetën vetëm për disa ditë të haxhxhit...
- nisen për në Arafat, periferi e Mekkes, që të kalojnë një ditë të thelluar në meditime. Para mbrëmjes nisen prej aty në drejtim të Mekkes. Natën e kalon në Muzdelife kurse në agimin e hershëm niset për në

Mina e cila gjendet shumë afër Mekkes.

- Aty mbeten tri ditë dhe gjatë këtyre ditëve për çdo ditë gjuhen gurët, vepër që simbolikisht paraqet gjuajtjen e djallit.

- Brenda këtyre tri ditëve në Mina theret kurban dhe shkohet në qytetin e Mekkes që të kryhet ceremoniali i tavafit dhe sa`jit (7 herë), duke kaluar luginën në mes dy kodrinave përballë Qabes, e që quhen Safa e Merve.

Të gjitha këto ceremoni të haxhxit kanë domethënie të tyre, ndërsa ne shkurtimisht vetëm do i përmendim disa prej tyre.

1. Shkuarja në Arafat

Kur Ademi a.s. dhe Hazreti Hava e humbën të drejtën e qëndrimit në Xhennet, ata u degmisën larg njëri tjetrit. Orvateshin që të takoheshin dhe me ndihmën e All-llahut u takuan në kodrinën e quajtur Arafat. Në shenjë falënderimi dhe nderi ndaj All-llahut xh.sh. pasardhësit e Ademit dhe Havas nisen për në Arafat, duke harruar veten dhe duke u shkrirë në prezencën e All-llahut xh.sh.

2. Gjuajtja e Djallit

Ibrahimi a.s. deklaroi se nuk do askënd më shumë se All-llahun xh.sh. Mirëpo, All-llahu xh.sh. e vuri në sprovë dhe lypi prej tij ta verifikoj dashurinë, ta bëj kurban birin e dashur. Djalli tri herë erdhi që ta largoj nga ky akt, në Mina, ndërsa Ibrahimi a.s. çdoherë e përzinte atë duke e gjuajtur me gurë.

3. Vizita e Shtëpisë së Zotit

Për të dokumentuar dëgjimin e vet, njeriu nisat drejtë saj me respekt të plotë dhe me nënshtrim. Të sillësh rreth dikujt do të thotë të përgatitesh të sakrifikosh për të, sepse ai është

objekt i dashurisë dhe besnikërisë tënde.

4. Guri i Zi

Ka disa kuptime të gabuara mbi të. Ai nuk është meteor, por gur i zi. Roli i tij praktik është të shënojë pikënisjen e tavafit, mirëpo me ngjyrën e vet bie në sy të ndërtesës. Ky gur, nuk adhurohet kurrë, as që muslimanët bien në sexhde drejtë gurit, pasi që bëhet sexhde për ballë çdo pjese të Qabes, por guri siç thamë shërben vetëm për pikënisje të tavafit.



5. Safa dhe Merva

Kur Ibrahimi a.s. patë lënë gruan e vet Haxheren me fëmijën për gjiri, Ismailin, në vendin e quajtur Mekke, ujin që ua la Ibrahimi a.s. u harxhua. Haxhereja nga dashuria e vet prindërore vrapoi majtas dhe djathtas të gjejë ujë për fëmijën e vet të etshëm. Ky gjest i saj përsëritet që të shprehet nderimi ndaj dashurisë prindërore dhe falënderim ndaj mëshirës së All-llahut xh.sh.

Këto ishin disa urtësi dhe simbolika të kushteve të haxhxit. E ti, o haxhi, a nuk ndjehesh i lumtur që jetëson urdhrin e All-llahut, përjeton çastet e Ibrahimit a.s. dhe dashurisë së tij ndaj All-llahut xh.sh., që e bënë të sakrifikoj më

të afërtin e tij? Këto çaste janë vërtetë të papërshkrueshme me fjalë dhe vërtetë mjaft mahnitëse.

Kur kishte pas pranuar Islamit boksieri Klevis Klej, kishte pas thënë: *“Unë pranova Islamit për shkak se pasb atë turmë njerëzish të gjithë të veshur në rroba ta njëjta, dhe të barabartë para Krijuesit të tyre, bile edhe Udhëheqësi i Shtetit kishte veshur rroba të tilla”*... Këtë barazi, o njeri, nuk mundesh ta gjesh në religjionin tjetër, e as në sistemin tjetër, por vetëm brenda Islamit, në konditat e tij. All-llahu xh.sh. është aq i mëshirshëm saqë obligim haxhxin ia ka bërë vetëm atyre që kanë mundësi udhëtimi, dhe atyre të cilët mund të arrijnë bile njëherë në jetë... E pse, ti jeton jashtë Islamit? A nuk logjikon? Vështro se çka thotë All-llahu i Madhërisëm për haxhxin:

“S’ka dyshim se ata të cilët nuk besuan dhe pengojnë prej rrugës së All-llahut dhe prej xhamisë së shenjtë (Qabes), të cilën Ne e bëmë të barabartë për njerëz, qofshin vendas ose të ardhur, dhe, kushdo që të përpiqet të bëjë ndonjë të keqe a ndonjë mëkat, Ne kemi për t’ua shijuar një dënim të idhët. Përkujtoje kur Ne e udhëzuan Ibrahimin për në vendin e shtëpisë (Qabës): të mos më përshkruaj Mua shok, pastroje shtëpinë Time për ata që e vizitojnë (bëjnë tavaf) që qëndrojnë në këmbë duke u falur, përkulur dhe që bëjnë sexhde. Dhe thirr ndër njerëz për haxhxin, se të vijnë ty këmbësorë e edhe kalorës me deve të rraskapitura që vijnë prej rrugëve të largëta. Për të qenë

të pranishëm në dobitë e tyre dhe që ta përmendin All-llahun në ato ditë të caktuara (në shenjë falënderimi) dhe për që i ka furnizuar me kafshë. Hani pra, prej tyre (kurbanëve) dhe ushqeni të ngushtuarin e të varfrin. Pastaj le të heqin papastërtinë e tyre, le t'i zbatojnë premtimet e veta dhe le të sillën (bëjnë tavaf) rreth shtëpisë së lashtë. Pra, kështu: Kush madhëron atë që All-llahu e bëri të shenjtë, ajo është më e dobishme për tek Zoti i vet. Juve u janë lejuar kafshët, pos atyre që u lexohen (në Kur'an) pra largohuni nga ndyrësitë e idhujve dhe largohuni fjalës shpifëse." [Kur'an 22:25-30].

"Edhe kur Ibrahim i dhe Ismaili, duke i ngritur themelet e shtëpisë (Qabes luteshin): "Zoti ynë, pranoje prej nesh, se me të vërtetë Ti je që dëgjon dhe di! Zoti ynë, bëna neve dyve besimtarë të sinqertë ndaj Teje dhe nga pasardhësit tanë, njerëz të bindur ndaj Teje, na e mëso manasikun (rregullat e adhurimit) dhe falna neve, vërtetë Ti je Falësi, Mëshiruesi!" [Kur'an 2: 127-128].

O njeri, medito vetëm për një moment mbi këto fjalë të All-llahut të Madhërishëm dhe ndjeje qetësinë që ta mundëson All-llahu yt ta ndjesh. Futu në brendësinë e shpirtit tënd dhe gjurmo mbi realitetin që fshihet në të... Dije se haxhxi të përgatitë për në xhihad në rrugën e All-llahut xh.sh. Karakteristikat themelore të haxhxit janë: udhëtimet, fjetja në tenda, ushqimi i lehtë e i

konservuar, larg specialiteteve të shijshme të cilat i hanë njeriu në jetën e përditshme, programi i gjumit ndryshe nga ai normal, fjetja në materiale të forta e shpeshherë edhe mbi dhe etj. Kjo është natyra edhe e jetës ushtarake, jetës së burrave të xhihadit.

Po ashtu edhe ata janë pandërprerë në udhëtim, flenë në tenda, e shpeshherë edhe në qiell të hapur, ushqimi i tyre është i konservuar, dhe shpeshherë mbesin pa bukë kohë të gjatë, rrallëherë mund të bëjnë gjumë të rehatshëm, ngase qëndrojnë nën tytat e tankeve, topave e automateve, e nuhatin vazhdimisht erën e barotit, flenë mbi tokë apo materiale tjera të forta etj.

muslimanëve të cilët gjenden në tenda vërtetë duke u përballuar me armikun e përbetuar të Islamit, dhe edhe ti për një moment i ndjen ato dhembje dhe atë krenari të të qenurit në rrugën e All-llahut. Haxhxi i fshin mëkatet, i mbulon mangësitë dhe i ndriçon anët e errëta të jetës së njeriut. Haxhxi ka edhe vështirësi, të cilat muslimani i tejkalon me kënaqësi të veçantë, sepse është i vetëdijshëm se me këtë shpreh përkulshmëri ndaj Zotit të vet.

Është më se e qartë që kur një musliman qëndron në këmbë, apo përkulet e përgjunjet gjatë të falurit, ai vetëm se është i ndjeshëm ndaj pranisë së të Madhërishmit, Zotit të lindjes dhe perëndimit. Është po aq e



Ti o i ri, përgatitesh për çdo situatë që të sakrifkohesh në rrugën e Zotit. Haxhxi ta mundëson një trajnim të posaçëm dhe një nostalgji për luftën në Islam. Ai të bashkon me zemrat e mijërave

qartë se të gjitha drejtimit janë të njësojta në vlerat e tyre materiale apo morale dhe asnjë drejtim nuk shenjtërohet thjesht për hir të vetëdrejtimit. Por, Zoti dëshiroi që Ai ta drejtonte të gjithë bashkërinë Islame në një

drejtim apo kible. Xhamitë e botës, në të gjitha kontinentet duhet të drejtohen kah ajo kible-drejtimi i xhamisë së parë të ngritur për adhurimin e Zotit të vërtetë. Bota muslimane përmes asaj kibleje lidhet me babanë e saj Ibrahimin a.s. dhe betohet se nuk do të devijojë nga doktrinat dhe parimet e profetëve të hershëm

Vështruar shkencërisht në haxhixh edhe gjejmë një lloj gjimnastike trupore. Haxhixhi është gjimnastikë trupore, për shkak të detyrimit që përmban rituali i haxhixhit si: tavafi, qëndrimi në Arafat, ecja nga Safa te Merva 7 herë etj. E mbase kjo është një prej atyre dobive që përfiton haxhiu në pelegrinazhin e tij.

Përfundimi i haxhixhit shënohet me një kremtim (Kurban Bajrami), që festohet me lutje. Kjo dhe Fitër Bajrami, ditë gostie që shënon fundin e Ramazanit, janë dy festat vjetore të kalendarit mysliman.

Pamë në pika të shkurtra se çka është haxhixhi, rëndësia e tij në Islam, simbolikat, rituallet etj. Tash në vazhdim do të sjellim edhe disa thënie të Muhammedit a.s. rreth kryerjes së haxhixhit, vlerës së tij në Islam dhe jetësimit të tij në jetët tona. “A s`është jeta e Pejgamberit a.s. shembull tipik për ju nëse dikush prej jush pengohet prej haxhixhit, bën tavaf (kur të mundet) Qaben, Safan dhe Mervan, pastaj lirohet nga (ihrami) deri në kryerjen e haxhixhit vitin vijues, therë kurban ose agjëron nëse nuk gjen kurban”.

“Nëse pengohem prej Qabes, do të veproj ashtu siç vepruam me Pejgamberin a.s. “Pastaj

vendosi për umren, sepse edhe Pejgamberi a.s. vendosi për umren vitin e Hudejbijes. Kështu Abdull-llah b.Umeri e shikoi këtë çështje dhe tha:

Qëllimi i vërtetë i (haxhixhit dhe umres) është një. Pastaj iu drejtua as-habëve të vet duke thënë: “Qëllimi i haxhixhit dhe umres është një. Ju marr dëshmitar se jam obliguar për kryerjen e haxhixhit me umren” Pastaj bëri një tavaf në emër të umres dhe haxhixhit pse konsideroi se kjo mjafton dhe më vonë theri kurban.”

“Mëkatet e vogla të bëra ndërmjet dy umreve janë të falura. Kurse për haxhin e pranuar, nuk ka shpërblim tjetër përveç Xhennetit.”

“Nuk ka ditë në të cilën All-llahu liron robër më shumë nga zjarri se në ditën e Arefatit .”

“Një umre në Ramazan është e barabartë me një haxhixh apo me një haxhixh me mua.”

Nga disa vështrime u munduam që të sqarojmë çështjen e haxhixhit në Islam dhe shpresojmë se ia kemi arritur qëllimit. Të All-llahut jemi dhe s`ka dyshim te Ai edhe do të kthehemi.

Literatura e konsultuar:

1. Kur`ani përkthim me komentim nga Sherif Ahmeti,
2. Sahihu-l-Buhari 5 përktheu Ismail Ahmedi , Prishtinë 1994
3. Rijadijus Salihin, Imam Nevevi , Logos-A Shkup 2003
4. Komenti i dyzet haditheve të Imam Neveviut, Dr.Mustafa el-Buga , Muhjedin Mistu, Furkan Ism Shkup 2003
5. Hyrje në Islam, Dr.Muhamed Hamidullah, Shkup 1985
6. Haxhixhi, -urtësitë e tij-, Bashkim Aliu Furkan Ism Shkup 2003
7. Ilmuddini, Bilal Hasanoviq , Furkan Ism Shkup 2000
8. Feja jonë, Muhamed Gazali , Tiranë 2003
9. Thesare në Kur`an, përshtatën Orieta Bulku dhe Saimir Bulku , Tiranë 2002
10. Udhërrëfyet i shkurtër i Islamit, I.A.Ibrahim, Prishtinë 2002

“Nuk ka ditë në të cilën All-llahu liron robër më shumë nga zjarri se në ditën e Arefatit .”

Porosi Profetike

SHKENCE

NJOHURI MBI SHKENCËN E FEVE KOMPARATIVE

Vijon nga numri 4 i
revistës

Feim Dragusha

I. PERIUDHA E ZANAFILLËS SË FEVE KOMPARATIVE

Kjo periudhë fillon me zbritjen e ajeteve kur'anore, të cilat bartin aspektin komparativ, si për shembull ajetet vijuese:


“Ju në vend të Allahut jeni duke adhuruar vetëm idhuj që i trilloni vetë si gënjeshtarë. S’ka dyshim se ata që i adhuroni në vend të Allahut, nuk posedojnë furnizimin tuaj, pra kërkojeni furnizimin te Allahu, adhurojeni Atë dhe shprehni falënderimin Atij, pse te Ai do të ktheheni”. [Kur’an 29:17].

“Atëherë pra, a është Ai që krijon njësoj, sikurse ai që nuk krijon? A nuk po mendoni”? [Kur’an 16:17].

“Vërtet, çështja e Isait (të lindur pa baba) tek Allahu është sikurse çështja e Ademit. Atë e krijoi Ai nga dheu, e pastaj atij i tha: “Ji’! ai qe”. [Kur’an 3:59].

Krahas këtyre ajeteve, kemi debatet dhe bisedat e Pejgamberit [alejhisselam], të cilat i zhvillonte me jehudet dhe të krishterët mbi Njëshmërinë dhe Pejgamberllëkun, si dhe

çështje tjera me rëndësi në lëmin religjioz. Këtë rrugë e ndoqën edhe shokët e Pejgamberit [alejhisselam], ku me vonë shohim një zhvillim të shkëlqyeshëm të shkrimit të kësaj shkence dhe regjistrimit të saj në libra dhe dorëshkrime të shumta, fat ky që gëzuan edhe shkencat tjera islame më parë.



II. PERIUDHA E SHKRIMIT TË SHKENCËS SË FEVE KOMPARATIVE

Periudha e parë, siç e cekëm edhe më lart, kishte të bënte më së shumti me debatet, bisedat dhe diskutimet e ndryshme në lëmin e feve. Kjo periudhë dallon nga e para. Në këtë kohë, çdo gjë filloi të ndërtohej dhe të regjistrohej nëpër libra dhe fletushka, e tërë kjo ndodhi si rezultat i nevojës së madhe që ndihej për studimin e shkencës në fjalë. Nuk ka dyshim se ecuria e kësaj periudhe nuk qe e shkurtër. Siç ceket edhe në librin

“Histroiku i Ibën Hishamit”, kjo shkencë zhvillohej hap pas hapi, derisa mori formën e saj të plotë. Për herë të parë, në historinë e feve komparative, shohim të ketë lulëzuar libri i njohur i Nubihtit ((النوبختي), i cili titullohej “ El-Aráu ved-dijanat” ((الأراء والديانات). Libri ishte shkruar në fund të shekullit të dytë (sipas kalendarit islam). Libri në fjalë posedon vlera të shumta shkencore, dhe mbarë dijetarët e kësaj shkence, e llogarisin si librin e parë të kësaj fushe.

Më vonë shohim edhe studime tjera në lëmin e krishterimit, të cilat i përkasin periudhës së dytë të kësaj shkence, respektivisht periudhës së shkrimit të saj. Ndërsa për vlerën dhe rëndësinë që i kushtojë shkencës komparative të feve dhe përkthimit të librave në këtë fushë, shohim se në kohën e Liderit Islam (Halifes), Harun Err-Reshidit, gjejmë përkthimin e Teuratit dhe Inxhilit(). Të dy këto libra ishin përkthyer nga dijetari dhe njohësi i gjuhëve të asaj kohe “Ahmed bin Abdullah bin Selam bin Halifeh.

Përkthimi i tyre më të vërtetë tregon përparimin dhe zhvillimin e shkencës së komparacionit. Më vonë, në kohën e Liderit të Muslimanëve, “El-Halifetu El-Me’mun”, zhvilloheshin debate dhe diskutime të vazhdueshme në lëmin e feve dhe religjioneve. Në

ato debate merrnin pjesë dijetarë dhe hulumtues të njohur të asaj kohe. Pra, kur kemi të bëjmë me debate të kësaj fushe, mund të nxjerrim edhe disa mësim të dobishme, që për të diskutuar me pasues të feve tjera, duhet të kihet parasysh edhe njohja e shumë shkencave tjera, pa të cilat debati nuk do të ketë fare sukses.

Si shkenca me rëndësi, mund t'i numërojmë; njohja e shkencës së Kur'anit; tefsiri, shkaqet e zbritjes së ajeteve, të gjitha këto luajnë rol qendror drejt argumentimit dhe shfuqizimit të argumenteve që vinë nga pala tjetër, po ashtu edhe shkenca e hadithit, historia e feve, njohja e gjuhëve të huaja, gjithashtu kërkohen nga debatuesi, pa të cilat rezultatet e debatit do të jenë jo efikase, në fakt, kjo për audiencën islame mund të ngjall edhe dyshime në besimin islam. Kemi shumë raste në Kosovë ku për shkaqe të mosnjohjes së gjuhës, apo si mungesë e kuadrove, persona jo kompetent marrin përsipër këtë përgjegjësi dhe si rrjedhojë munden nga pala tjetër.

III. PERIUDHA E ZHVILLIMIT DHE VAZHDIMËSISË SË KOMPACIONIT

Këtë periudhë, për dallim nga dy të parat, e karakterizon zhvillimi i hovshëm në nxjerrjen dhe lulëzimin e shumë librave dhe hulumtimeve komparative (krahasuese). Interesimi i madh i dijetarëve dhe hulumtuesve

islam, kishte rezultuar në shtimin dhe studimin e debateve nga më të ndryshmet, veçmas duke filluar nga shekulli i dytë hixhrij, e gjerë në shekullin e nëntë. Gjatë këtyre shekujve, dijetarët islam dhuruan një kontribut të çmuar, duke lënë pas tyre libra dhe dorëshkrime me renome botërore në lëmin e kësaj shkenca.

S'do mend se edhe njohja e gjuhëve luajti rol të rëndësishëm ku ndihmoi në përkthimin e shumë librave në gjuhën arabe, përndryshe, nuk do të ishte e logjikshme që të njiheshin ndasitë e burimeve të çdo feje, po që se nuk përktheheshin edhe literaturat përkatëse. Pra, siç u potencua edhe më lartë mund të konkludojmë se këtë periudhë e karakterizon botimi i librave të shumta. Në vazhdim do të cekim emrat e dijetarëve të veshëm të këtij lëmi dhe kontributin e tyre shkencor, gjithnjë duke pasur parasysh që përmes shkrimeve të tyre, të paraqesim argumentet bindëse mbi vërtetësinë e Islamit dhe librit të shenjtë, Kur'anin. Titujt e tyre shkencor janë siç vijojnë:

Nuhbihti ((النوبختي)) me librin e tij të mirënjohur "*El-Arau veddijanat*", (الأراء والديانات), libër ky i radhitur ndër më të parët në fushën e komparacionit. (Për lindjen e tij nuk kemi asnjë të dhënë, për fat të mirë, viti i vdekjes së Nuhbihtit është cekur edhe në literaturën islame, ai kishte vdekur në vitin 202 hixhrij), pra, nga kjo shohim se shkenca e komparacionit na qenka shumë e vjetër, vet libri i tij "*Mendimet dhe Fetë*", na

jep të kuptojmë se ka pasur studime serioze në atë kohë dhe atë duke u bazuar në titullin e librit të sipërshtuar, si do që të jetë, ky është libri i parë që na ka arritur në duart tona dhe si i tillë meriton të renditet nga më të parët.

El-Mes'udij ((المسعودي)) kishte shkruar dy punime në këtë drejtim:

1) *El-Mesail vel-ilel Fil Medhabibi vel Milel* (المسائل والعلل في المذاهب والملل)

2) *Sirrul Hajab* (سرر) Bazuar në datën e vdekjes së autorit, (vdiq në vitin 346 hixhri), shohim se librat e punuar nga ky Dijetar, tregojnë se nuk kishte ndonjë rënie të interesimit mbi këtë fushë, në fakt, interesimi i dijetarëve dhe literatura e tyre sa vinte e shtohet.

Ebul Hasen El-Amirij (أبو الحسن العامري) (vdiq në vitin 381 hixhri), kishte shkruar librin e tij shumë të njohur: "*El'I'lam Bimenakibil Islam*" (الإعلام بمناقب الإسلام).

El-Mesbehij (المسبحي) (vdiq në vitin 420 hixhri), Autori në fjalë kishte shkruar librin "*Derkul Begijeh*" (درك البغية), në të cilin kishte përshkruar fetë dhe ritet fetare.

Eburrejhaan El-Bejruni (أبو الريحان البيروني) (vdiq në vitin 425 hixhri). Bejruni kishte përgatitur punimin e tij të titulluar: "*Tabkik ma lilhindi min mekuletin makbuletin fil Akli Ev Merdbuletin*", (تحقيق ما للهند من مقولة مقبولة في العقل أو مردولة).

Ebu Mensur El-Bagdadi (أبو منصور البغدادي), (vdiq në vitin 429 hixhri), punimi i tij titullohej “*El-Milel Ven-Nihel*” (الملل والنحل).

Ibn Hazm El-Endelusij (ابن حزم الأندلسي), (vdiq në vitin 456), libri i tij titullohej: “*Elfaslu Fil Mileli Vel Ehva Ven-Nihel* (الفصل في الملل والأهواء والنحل).

Esh-shehrestani, (الشهرستاني), (vdiq në vitin 458hixhri), punimi i Dijetarit të mirënjohur Esh-shehrestan, titullohej: “*El-Milel Ven-Nihel*” (Libri në fjalë edhe sot e kësaj dite mësohet në shumë Universitete Islame.

El-Gazali, (الغزالي), (vdiq në vitin 505 hixhri), libri i tij quhet “*Err-rrred El-xhemil*” (الرد الجميل) punim shumë i dobishëm në lëmin e debateve religjioze, për të cilin Prof. Dr. Abdul Aziz Abdul Hak Hilmi, thotë se ishte shkruar në Aleksandri nga pena e Dijetarit Imam el Gazali [Mëshira e Allahut çoftë mbi shpirtin e tij]. Mendimin e tij e mbështet në atë se, në Aleksandri ngjalleshin shumë debate në fusha të ndryshme, në veçanti debatet që kishin të bënin me krishterimin e vjetër, prandaj, qyteti i Aleksandrisë, i kushtonte rëndësi të veçantë kësaj fushe. Mos të harrojmë se Abdul Aziz ishte edhe recensues i librit: “*Err-rrred El-xhemil*”.

Ebu El-beka Salib Bin El-Husejn أبو البقاء صالح بن الحسين الجعفرى (ky dijetar kishte jetuar pas Imam El-Gazaliut, dhe kishte vdekur në vitin 661), ndërsa libri i tij quhej: “*Tahxhilun min Harfi Et-tevrat vel-Inxhil*”, (تخجيل من حرف التوراة والإنجيل).

Ahmed bin Idris El-Karafi El-Malikij, (أحمد بن إدريس القرافي), (vdiq në vitin 684 hixhri). El-karafi librin e tij e kishte titulluar: “*El-Exhvibetu El-Fabiretu*” (الأجوية الفاخرة).

Ahmed bin Tejmije (أحمد بن أحمد بن تيمية), (vdiq në vitin 628 hixhri), punimi i tij quhej: “*El-xhevab Es-sahib Limen Bed-del Dinul Mesih*”, (الجواب الصحيح لمن بدل دين المسيح).

Ibën Kajim El-Xhevzije (ابن قيم الجوزية), (vdiq në vitin 751hixhri), libri i tij në lemin e feve quhej: “*Hidajetul Hijarij minel Jebud Ven-nesara*” (هداية الحيارى من اليهود والنصارى).

Esh-shejh Abdullah Et-Terxhuman (الشيخ عبد الله الترجمان), (vdiq në vitin 823 hixhri), libri i Abdullah Terxhumanit, titullohej; “*Tuhfetu El-Erib Firr-rrredi Ala Ehli Es-salib*”, (تحفة الأريب في الرد على أهل الصليب).

Këto ishin disa nga librat e dijetarëve të vjetër, të cilat edhe sot studiohen me përkushtim të madh. Lexuesi, tashmë do të ketë një diapazon më të gjerë në lëmin e shkencës së komparacionit si dhe ecurinë e saj përgjatë shekujve, duke parë

se kontributi i dijetarëve në fushën e feve komparative, duke filluar që nga shekulli II hixhri, e gjerë në fillim të shekullit të VIII hixhri, ishte i çmueshëm dhe efektiv.

Prandaj, librat e sipërshënuara konsiderohen nga më të rëndësishmet. Vlen të theksohet se në mesin e tyre kishte dijetarë të enciklopedisë islame, si shembulli i Imam ibën Tejmijes, Imam Gazaliut, Shehrestanit, të cilët jo vetëm që punuan në drejtim të kësaj shkence, në fakt ata ujitën tokën me njohuri të përgjithshme të të gjitha sferave, prandaj, kohën e tyre e ndanin edhe për zhvillimin e shkencës së feve krahasuese, e cila ka për synim njohjen e studiuesit me besimet dhe akaidet e këtyre pasuesve, pa marrë parasysh, pasues të feve qiellore qenë ata apo të feve tjera që si burim kanë mendjen e njeriut.

Do të kishte qenë në interes të lexuesit që t'i kthehet edhe librave të tjerë që kanë të bëjnë me këtë fushë të studimit. Si libra të tjerë të dobishëm për lexuesit, do të kisha cekur edhe librin “*Kitabul Fusul li Ebil Hasen El-Esh’arij*”, i cili si libër voluminoz, sqaron kundërpërgjigjet e Ebil Hasen El-Esh’arij ndaj brehamive, jehudëve, krishterëve dhe zjarrputistëve.

P.S. Fusnotat dhe referencat janë hequr!

Tema Vazhdon

PERSONALITET

IMAM AHMED IBN HANBEL

Berat Hashani

Lindja dhe origjina e Imam Ahmed ibn Hanbelit

Imam Ahmed ibn Hanbel ka lindur në vitin 164 hixhri në qytetin Medinë të Arabisë Saudite.

Imam Ahmed i rrjedh nga fisi Shejban Reb'a Nezara. Ku gjen lidhje farefisnore me të dërguarin Muhammed a.s te Nezara.

Rebia dhe Madar kanë qenë vëllezër, dhe të dy ishin bijtë e Nezarit i cili ishte njëri nga stërgjyshërit e të dërguarit Muhammed a.s.

Babai i Imam Ahmedit quhej Muhamed. Të gjitha burimet pajtohen në atë se ai kishte vdekur i ri kur kishte vetëm tridhjetë vite. Imam Ahmed kishte lindur po në atë vit në të cilin i Ati i tij kishte vdekur.

Ndërsa gjyshi i Imam Ahmedit ishte Hanbel ibnu Hilal ibnu Esed. Ai zotëronte postin e udhëheqësit të fisit të tij. Dhe ishte njëri nga njerëzit që gjente pozitë të lartë në shtet.

Nga ajo që gjejmë rreth biografisë së Imam Ahmedit është se ai ishte rritur jetim. Ai kishte thënë: Nuk e kam arritur gjyshin e as babanë tim. Shembulli i tij po ai i mësuesit të tij Imam Shafiut.

Imam Ahmed ibnu Hanbel gjen vendin në mesin e katër imamëve më të dalluar të Ehli Sunnetit, ku renditet imami i katërt sipas kohës në të cilën jetoi.

Edukimi i Imam Ahmed ibn Hanbelit

Imam Ahmed i qysh nga vitet e hershme të fëmijërisë së tij gjen interesim të veçantë rreth diturisë, ku mu në atë kohë fillon të mësojë Kur'anin përmendësh. Filloi të i kushtojë kohë mësimi të gjuhës arabe. Shembulli i tij në mësimin e gjuhës ishte po ai i të gjithë fëmijëve arabë të cilët gjenin kujdesin e veçantë nga prindërit e tyre për mësimin e gjuhës.

Me të arritur vitet e pjekurisë së plotë Imam Ahmed i fillon të vizitoi disa nga qytetet ku atje vijonte mësimet, si në qytetet: Kufë, Bagdad, Sana'a, Basra të Irakut të sotëm ku me të zbritur në të çdo herë praktikonte të falë namaz në xhaminë e quajtur Mazin. Dhe një herë ishte pyetur, se pse vepron çdo herë këtë? Ai thoshte: Ngase kjo është xhamia e stërgjyshërve të mi.

Imam Ahmed i kishte kaluar e tërë kohën e jetës së tij i përkushtuar në dituri.

Ai interesim të veçantë i kishte kushtuar mësimi dhe tubimit të haditheve të të Dërguarit a.s, gjithashtu mësimi të Kur'anit, shkencës së Usuli Fikhit, Hadithit.

Sa i përket nxënies së haditheve Imam Ahmed i thoshte: **I pari nga i cili kam shkruar hadithin e të dërguarit a.s ishte Ebu Jusufi.**

Ebu Jusufi në atë kohë luante rolin e gjykatësit supreme në shtet. Dhe ishte nxënësi më i dalluar i Imam Ebu Hanifes.

Disa nga dijetarët e të cilët Imam Ahmed i kishte vijuar mësimet

Ashtu si e cekëm më lartë Imam Ahmed i filloi të shkruajë hadithet e të Dërguarit a.s nga Ebi Jusuf. Edhe pse shkolla e Ebi Jusufit njihet si qendër ku vend të veçante në të gjykuar zinte mendja, megjithëkëtë gjejmë Imam Ahmedin i cili qysh me të filluar merr qëndrim më ndryshe nga mësuesi i tij Ebi Jusufi.

Pas një periudhe kohore të mësimi me dijetarin Ebi Jusuf, Imam Ahmed i shkoi në Bagdad ku filloi të vijojë mësimet në shkencën e Fikhut te dijetari Hushejm ibn Beshir El-Vasitij.

Imam Ahmed i kaloi një pjesë kohore me këtë dijetar i cili veçohej si dijetar i sinqertë dhe me respekt të lartë te njerëzit.

Imam Ahmed i thoshte fillova të marr mësim nga Hushejm ibn Beshir El-Vasitij qysh nga viti 179 hixhri ku vazhdova te ai mësimet deri në vitin 183. Nga ai morra njëmijë hadithe rreth Haxhit, diç nga Tefsiri, gjithashtu mori hadithe rreth të gjykuarit në Islam etj.

Më pas Imam Ahmed i kaloi në qytetin Basra ku aty vazhdoi mësimet te dijetari më i dalluar i hadithit Abdurrahman ibn Mehdi, jo vetëm në këtë qytet, por thuajse në tërë Irakun. Ky dijetar ishte ai i cili kishte kërkuar nga Imam Shafiut që të shkruaj librin të quajtur Errrisaleh.

Nga ajo çka gjejmë nga biografia e Imam Ahmedit është

se mësuesit e tij ishin dijetarët më të dalluar të asaj kohe si: Jahja ibn Adem, Seid ibn Sebah, Ismail ibn Xhafer.

Imam Ahmedi kishte nxënë Kur'an dhe mësuar shkencën e Texhvidit nga Ismail ibn Xhafer i cili ishte përgjegjës i Kur'anit në qytetin Medinë.

Sprova e Imam Ahmed ibnu Hanbelit

Pasi që mbreti Memun mbante mendimin e grupit Mutezil se fjalët e librit të shenjtë Kur'anit janë të krijuara, kishte urdhëruar të gjithë njerëzit e lart të të gjitha qyteteve të cilat i mbizotëronte që t'i largojnë të gjithë ata të cilët nuk mbajnë mendimin e krijimit të Kur'anit.

Imam Ahmedi kishte parë se të besuarit se Kur'ani është i krijuar qon në mendim të rrezikshëm rreth All-llahut subhanehu we teal.

Mu për këtë Imam Ahmedi ngritë zërin dhe refuzon mendimin e Muteziles, me dallim nga disa dijetarë të asaj kohe nga frika e mbretit Memun dhe e njerëzve të tij përkrahnin mendimin e krijimit të Kur'anit.

Më pas mbreti Memun kishte dëgjuar rreth Imam Ahmedit dhe kishte urdhëruar njerëzit e tij që t'ia dorëzonin atë dhe të gjykohej ndaj tij me vdekje. Pasi që të dërguarit e mbretit kishin vë në pranga Imam Ahmedin rrugës për te mbreti Memun atyre iu mbërrin lajmi se mbreti Memun kishte vdekur. Ashtu në pranga Imam Ahmedi dërgohet në burg në Bagdad.

Pozitën e mbretit e merr Mutesim, ku me vendimin e tij Imam Ahmedi kishte qëndruar në burg 28 muaj ku ishte

torturuar e rrahur.

Me të ardhur në krye të shtetit i biri i mbretit Mutesim mbreti Ebu Xhafer e liron atë nga burgu dhe e urdhëron atë që të jetoj larg masës i fshehur.

Pas mbretit Ebu Xhafer në krye të shtetit vjen El-Mutewekili i cili me të ardhur në postin e mbretit fillon ta nderojë pa masë Imam Ahmedin, të cilit i kishte përgatitur disa nga dhurata të çmueshme, mirëpo Imam Ahmed i kishte refuzuar ato. Mbreti urdhëron që diskutimi rreth asaj se a është Kur'ani i krijuar apo jo të të heshtet dhe të mos dialogohet më.

Lëvdatat drejtuar Imam Ahmed ibnu Hanbelit

Njeri nga dijetarët e hadithit në Bagdad Hejthem ibn Gjamil kishte thënë për Imam Ahmedin kur ky ishte i ri: **Nëse jeton ky djalosh, do të jetë argument për bashkëkohësit e tij.**

Imam Shafiu kishte thënë një herë: **Kur unë lëshova qytetin Bagdad, nuk lash pas vete asnjë njeri më të mençur dhe njohës më të mirë të fesë se Imam Ahmedin.**

Dijetari Ibrahim El-Harbij kishte thënë: **Takova njëherë Imam Ahmedin dhe gjeta tek ai se sikur All-llahu subhanehu we teal i kishte dhënë diturinë e të parëve dhe të fundit.**

Referencat:

Mustafa Esh-shuka'a, **El-Eimmetu El-Erba'atu**, botimi i parë, Daru El-Kutub El-lubnanije, viti i botimit- 1983, Bejrut - Lubnan.

Faqe e Internetit: http://www.geocities.com/e_sohel/tareekh/tareekh13.htm

Faqe e Internetit: <http://www.ebnmasr.net/forum/t45360.html>.

Vdekja e Imam Ahmed ibnu Hanbelit

Imam Ahmedi kishte vdekur ditën e xhuma, viti 241 hixhri. Ai kishte jetuar gjithsej 77 vite.

Në ditën e varrimit të tij ishin tubuar aq shumë njerëz sa që edhe rrugë të tëra kishin qenë të stëmbushura nga njerëzit, ku numri i tyre arrinte deri në njëqind mijë vetë, dhe rrëfeshet se edhe më shumë se kjo.

Ai ishte varrosur në qytetin Bagdad. Dhe tregohet se njëzet mijë njerëz nga Jehudë, të Krishterë dhe Megjusë/zjarrputistë kishin kaluar në islam në ditën e varrimit të tij.

“Kur unë lëshova qytetin Bagdad, nuk lash pas vete asnjë njeri më të mençur dhe njohës më të mirë të fesë se Imam Ahmedin.”

Imam Shafiu

ME SHKAS

EDHE NE JEMI PJESË E BOTËS, EDHE NE E DUAM LIRINË

Ardian Sejdiu

Ditët rrjedhin njëra pas tjetrës pa ndalë së bashku me mizorinë barbare që të tjerët e ushtrojnë ndaj muslimanëve të pa fajshëm kudo në sipërfaqen e tokës. Faqet e gazetës për çdo ditë janë të mbushura me lajme fatkeqe që e dëshmojnë mizorinë të cilën e përjetojnë muslimanët anë e kënd botës nga dora gjakpirëse. Burgjet famëkeqe kudo në botë janë të stërmbyshura me muslimanë të pafajshëm. Gjaku i tyre është bërë më i lirë se sa një pikë gjak e bishës së egër. Vuajtjet dhe torturat të cilat i përjetojnë ditë dhe net nuk kanë të ndalur. Dhembjet e tyre janë të pa përshkruara.

Rënkimet e tyre nga të rrahurit janë marramendëse. Zëri i tyre për shpëtim ka hasur në vesh të shurdhër. Dita dhe nata për ta është bërë e njëjtë. Errësira e qelisë ua ka marr të pamurit. Zëri i kamxhikut është bërë melodi e vajtimit.

Kudo në skaje të botës rrezet e diellit shndërritin tokën, ndërsa në tokat e muslimanëve rrezet e diellit janë zbeh. Shumë nëna kanë mbet pa fëmijë, shumë gra kanë mbet pa burra, shumë fëmijë kanë mbetur pa më të dashurën nënë. Edhe lulet janë vyshkur në duart e fëmijëve

duke i pritur prindërit e tyre të dalin nga burgjet famëkeqe.

Edhe buzëqeshja e tyre është tharë. Kafshata e thatë e bukës në duart e tyre është ujitur me lot të pafajshëm. I kanë harruar ditët e gëzimit, sepse ditët e pikëllimit zgjatën me vite. Brohoritjet e tyre s'kanë të ndalur, edhe ne jemi pjesë e



botës, edhe ne duam liri. Por, fatkeqësisht zëri i tyre i lodhur ka hasur në veshët e shurdhër. Drejtësia është fundosur thellë në errësi.

Askush nuk pyet për fajin e tyre, sepse faji i tyre dihet, vetëm se ata janë muslimanë. Emri musliman në veshët e gjakpirësve tingëllon vrazhdë. Muslimani në syrin e mizorëve duket sikur të jetë najë bishë e egër i ardhur nga tjetri planet. Tamam i përngjan skenarit në xhungël, ku i forti e zhdukë të dobëtin. Bindjet dhe personaliteti i muslimanit

luftohet kudo në botë me metoda të ndryshme mizore. Nuk e kuptoj pse e gjithë kjo mizori ndaj muslimanëve pikërisht në shekullin 21? Vallë, çka fshihet pas kësaj? Sot ekzistojnë shoqata të ndryshme të cilat i mbrojnë të drejtat e kafshëve, e të drejtat e muslimanëve luftohen kudo në botë. Pra, kush është përgjegjës për mbrojtjen e gjakut të pafajshëm të muslimanëve, dhe kush janë ata të cilët duhet të përgjigjen para drejtësisë për gjakderdhje? Gjaku i muslimanit është bërë shënjestër. Mbyttjet dhe masakrimet e muslimanëve me metoda barbare marramendëse janë aktuale për çdo ditë. Bota është

dëshmitare se çka ngjau me muslimanët në Indi para disa muajve. Farë dhembje përjetuan muslimanët nga dora e mizorëve të cilët përkulën para kafshëve. Lopa tek ata është më e vlefshme se njeriu i shekullit 21. Atyre nuk u mjaftoi mbytja e burrave, pleqve, grave, fëmijëve muslimanë por edhe i masakruan dhe i dogjën. O ju gjakpirës, as djegia e as vdekja nuk e luhat besimin e muslimanit. Ju ushtruat dhunë ndaj tyre, e ata vdiqën krenar se janë të pafajshëm. Krenarinë e tyre e dëshmoi Allahu prej

shtatit qiell, Ai tha: **“E nuk patën pse t’i urrejnë, përveç që e besuan All-llahun, ngadhënjesisin, të lavdëruarin.”** (El-Buruxh:8).

Ata e përjetuan zjarrin e kësaj bote dhe inshaAllah nuk do ta përjetojnë zjarrin e botës tjetër. E ju gjakpirës të cilët dëfreheshit në momentin e djegies së tyre, do t’u vije një ditë ku do ta përjetoni zjarrin e botës tjetër. **“Është e sigurt se ata që i sprovuan besimtarët dhe besimtare dhe nuk u penduan, ata kanë dënimin e xhehennemit dhe dënimin e djegies.”** (El-Buruxh:10).

Bota me heshtje sikur e përshëndeti këtë akt barbar, e heshtja është miratim. Ajo çka është e ditur historikisht, se lufta mes të vërtetës dhe të kotës ka ekzistuar gjithmonë. Gjithashtu dihet mirë se bindjet nuk ndryshohen lehtë, mandej edhe nëse trupi fizik i përjeton mundimet nga më të ndryshmet. Nëse të tjerët pretendojnë ta zhveshin muslimanin prej besimit, kjo është e pamundur. Besimi është çështje e ngulitur në shpirt, e shpirtin s’ka mundësi me robëruar askush.

Jemi dëshmitarë të historisë, se gjithherë kur të tjerët kanë tentuar ta zhdukin islamit dhe muslimanët në ndonjë vend, mu aty është forcuar edhe më tepër. Islami i ka rrënjët thellë të ngulitura në tokë, ndërsa degët lartë në qiell. Besimin e muslimanit nuk e lëkundin furtunat e jetës. Besimi dhe liria janë principe bazë tek jeta muslimanit. Këto dy komponentë janë themel i jetës. Çdo njeri në këtë botë duhet ta gëzojë lirinë. Mizorët në vend se të kultivojnë liri, ata i privojnë

njerëzit nga liria. Në vend se të përkundin djepa të rinj, ata hapin varre të rreja. Të mallkuar qofshin ata të cilët i privojnë muslimanët nga liria!

Shpresojmë me bindje të thellë, se një dite lotët e nënave dhe fëmijëve musliman të pafajshëm do të bëhen rënd për armikun. Gjaku i pafajshëm i fëmijëve, pleqve, grave dhe burrave musliman të cilët vdiqën nga dora barbare, një ditë do të bëhet grusht i rënd kundër mizorëve. E afërt është ajo ditë që edhe fëmijëve musliman do t’ju kthehet buzëqeshja, edhe atyre do t’ju ndalën lotët përgjithmonë...



“E afërt është ajo ditë që edhe fëmijëve musliman do t’ju kthehet buzëqeshja, edhe atyre do t’ju ndalën lotët përgjithmonë...”

PËRSIATJE

DHUNA MODERNE MBI FEMRAT

Nexhat Ibrahim

Prizren

Hyrje

Ditëve të fundit kryeparlamentarja e Shqipërisë, zonja Jozefina Topalli, ndërmoi një fushatë kundër dhunës ndaj femrës. Në e-majlin që pranova nga sekretaria e saj lexova nismën e saj dhe në përgjigjen time, të cilin ia dërgova, i dhashë përkrahje të plotë, duke i bërë edhe ca vrojtime, pa të cilat, mendoj, nisma e saj nuk do të ishte e frytshme, e plotë dhe efikase. Për mos ta zgjatur, në vazhdim do t'i shtrojmë disa përsiatje.

Ç'është dhuna mbi femrën

Dhunë ndaj femrës konsiderohet çdo lloj dhune e bazuar në gjini e cila rezulton ose mund të rezultojë me lëndim ose vuatje fizike, seksuale apo psikologjike të femrës.[1] Ky shkrim nuk do të trajtojë mavijosjet e femrës, eshtrat apo brinjët e thyer e të ngjashme, por do të trajtojë forma shumë më perfide të dhunës mbi femrën, e të cilat në jashtësi përcillen me buzagaz e m i r ë s j e l l j e . Psikiatri amerikan Skot Peck të keqen e përkufizon si “e keqja

është imponimi i vullnetit vetjak me qëllim të pengimit të zhvillimit shpirtëror.”[2] Thënë ndryshe, çdokush që palës tjetër përpiket t'ia imponojë konceptet vetjake të të kuptuarit të dukurive të caktuara pa i lënë hapësirë për mospajtim ose qëndrim tjetërfare, ai bën



ndërhyrje, asfiksion dhe pengim të tjetrit, dhe do të shkaktojë hendikep të përhershëm në pikëpamjen mentale të personalitetit ose grupit me të cilin është manipuluar. Është lehtë të dëshmohet dhe demonstron kjo gjendje. Vetëm nëse e hapim televizorin, brenda dite, femrën do ta gjejmë si objekt reklamues apo si objekt që reklamon gjerat e ndryshme: aeroplanët, automjetet, rrobat e ndryshme, ushqimet e ndryshme; ajo është objekt epshi, perversiteti, shfrenie, komercializmi.

Vendtorturimet moderne të femrës

Evropa nga shekulli XV-XIX ka qenë një vend torturues i femrës që është vështirë t'ia gjesësh shoqen në histori. Gjuatja e shtrigave në Evropë ka marrë pas vetes deri në 9 milionë koka femrash.[3] Pas kësaj dhune qëndronte kryesisht Kisha katolike dhe priftërinjtë e saj dhe instrumenti i saj – shteti. Kisha femrën e konsideronte si krijesë të keqe, krijesë të ligë që e nxori Adamin nga parajsja, krijesë që meriton vetëm vdekje. [4] Kisha sidomos ishte alergjike ndaj femrave intelektuale, duke i shpallur ato për shtriga. Shtrigat zakonisht digjeshin mizorisht, vareshin, shqyheshin deri në

vdekje. Opinioni manipulohet se femrat e këtitilla kanë prekur sedrën e Kishës, të vërtetat e Zotit dhe si të tilla meritojnë vetëm vdekje të dhembshme. Njëkohësisht, kjo ishte vërejtja e fundit edhe për femrat e tjera, se femrat janë të krijuara vetëm për plotësimin e kënaqësive të epsheve. Asgjë më shumë. Si qëndron puna sot? A kemi dhunë të tillë sot kur fenë e shporrëm nga jeta publike, politike, ekonomike, kur e vendosëm në muzeume? Sot femra kërkohet në politikë, ekonomi, kulturë, sport!

Ajo është pjesëmarrëse në vendimmarrje! Pas kësaj që shohim, ç'mund të themi: kemi dhunë sot dhe kush është fajtorë për këtë dhunë nëse ajo ekziston?

Për fat të keq, femra është pjesëmarrëse në jetën publike, por jo në aspekt që flitet. Prosperimi i saj lidhet ngusht me nevojat e epshet e ulta të meshkujve. Vendtorturimi modern i saj është puna e saj si top-modele, këngëtare, moderatore e show-programeve të ndryshme, për t'i kënaqur sytë e pangopur të mashkullit moralisht të kalbur. Kodoshllëku modern nuk dallon nga ai i vjetri, të fitojë në dëm të tjetrit, normalisht, duke i modernizuar mënyrat organizative. Tash, në krahasim më të shkuarën, kemi më shumë qeshje, më shumë retorikë erotike, përkulje perfide të vazhdueshme, si puthja e dorës, hapja e derës në automjet, dhënia përparësi në hyrje-dalje etj.

Prototipi i femrës moderne

Nëse i hedhim një vështrim personazheve dhe profilit të femrës në letërsi për fëmijë apo edhe në zhanret e tjera, do të shohim një gjendje të çuditshme. Këta personazhë janë figura moralisht të diskutueshme, me shprehje negative, me zhvillim psiko-fizik të gabueshëm. Për fat të keq, këta figura janë bërë prototipë të femrës moderne. Edhe Borëbardha, edhe Kësulkuqja, edhe Pipi çorapëgjatë, edhe Alisa nga bota e çudirave, zakonisht nuk kanë më të afërmit e tyre për mbëltrim të dashurisë dhe edukimit cilësor. Këta personazhë zakonisht janë mjaft naivë dhe

zakonisht ata nuk i shpëton dija, morali, apo meditimi, por princi i pasur. Pason dashurimi në shikim të parë, pa njohjen e ndërsjellë. Për të pranuar martesën Borëbardhës i është nevojitur vetëm një buzëqeshje dhe puthje dhe xhepi përplotë para nga Princi. Lumturia e Borëbardhës dhe Princit, në të cilën thirret autori, nuk çojnë më tej se Borëbardha të vendoset në rolin e ajrosjes së pallatit, pastrimit të pluhurit, bërjes së ëmbëlsirave e të ngjashme. Thjesht, femrën e shohim si prototip të krijesës për shfrenim e kënaqësi, naive, të krijuar për punë shërbyese, por jo edhe intelektuale; atë e shohim jo si qenie që ndihmon njerëzinë me intelekt e shpirt, por me trup dhe bukuri.

Çështjet e mirëfillta

Në fillim të erës islame, femrat sahabë të Muhammedit a.s. merrnin pjesë aktive në shpjegimin dhe interpretimin e shumë çështjeve, duke i shtruar pyetje Muhammedit a.s.. Pyetjet ishin të natyrës së ritualeve, të drejtave ndërnjerëzore, bontonit, vesh-mbathjes, transaksioneve ekonomike etj.. Muhammedi a.s. i ka përkrahur ato dhe kjo mund të vërehet edhe sot nga dora e parë nga burimet muslimane të hadithit dhe rasteve të shkruara. Kjo klimë pozitive ka ndikuar që në atë kohë të zhvillohen femra me aftësi të mëdha intelektuale dhe gjyquese. Ky ritëm ka vazhduar edhe në kohën e mëvonshme, por jo edhe në periudhën e stagnimit musliman, kur mashkulli është kënaqur që femra t'i bëhet lavatriqe e mirë, kuzhinierë e mirë, pastruese shtëpie dhe riprodhuese e mirë,

por jo edhe intelektuale e mirë. Anatomia e dhunës

Dhuna është rezultat i konfliktit e konflikti është rezultat i mosmarrëveshjeve. Mosmarrëveshjet janë pasojë e aksesit të gabueshëm në vlerësimin e dallimeve. Edhe pse dallimi, qoftë fizik, intelektual apo material, duhet në jetë në funksion të pasurimit dhe mirëkuptimit (li te'arefû), në sytë e njerëzve egoistë dhe prepotentë, dallimi bëhet zjarr për iniciimin e konfliktit të interesit, deri sa konflikti i interesit rezulton në përdorimin e aspekteve të ndryshme të dominimit, ku bën pjesë edhe forca. Nëse konstelacionin e sipërm e vendosim në nivel rajonal apo ndërkombëtar, do të shohim se shumë shtete sillen pikërisht në këtë mënyrë, duke i detyruar popujt e vegjël apo të dobët në heqje dorë nga shumë gjera me rëndësi dhe në privilegje të të pasurve dhe të fortëve. Pikërisht sikurse këto shtete të dobëta e të painformuara, edhe meshkujt^[5] dhe femrat bëhen pre, viktimë e lehtë në arenën botërore të dominimit dhe interesit.

Akcesi ndaj sfidave

Njeriu ka prirje që për mossuksesin e tij ta akuzojë dikë tjetër, zakonisht faktorët e jashtëm, që mos të ballafaqohet me mangësitë personale. Djemtë dhe vajzat për mossukseset e tyre akuzojnë kolegët e shpesh edhe fajin ia lënë sihrit dhe magjisë në vend që të hulumtojnë dhe eliminojnë mangësitë vetjake. Me qëllim që të mbrojnë paraqitjen pozitive për veten, njeriu ka krijuar mekanizma të

shumtë për të mbrojtur vrimat ‘e zeza’ në personalitetin e tij. Ky akses është nga jashtë brenda (outside-in) dhe manifestohet duke gjetur alibi për mangësitë



vetjake në faktorët e jashtëm.

Akcesi i dytë është nga brenda jashtë (inside-out) dhe nënkupton ndërtimin maksimal të vetes dhe ndërrimin e personalitetit vetjak. Kjo konsiston në bindjen që njeriut askush nuk mund t'i bëjë keq përveç nëse në këtë ai/ajo lejon. Apo, njeriun askush nuk mund ta turpërojë më shumë se sa ai vetveten.

Njerëzit martohen, miqësohen apo hyjnë në institucione duke kërkuar më shumë mirëkuptim, dashuri, shërbime, ngushëllime, kohë dhe në këtë rreth prej shumë individëve që gërshetohen, ku shumica shumë më tepër kërkon se sa ofron, lindin boshllëqe të zgjeruara të cilat gjenerojnë jaze të pakalueshme dhe ftohtësi mes veti.

Brezat e parë të muslimanëve dallohen prej të sotmëve me atë që ata ishin njerëz të mëdhenj të cilët erdhën ta lumturojnë këtë planetë të vogël, deri sa muslimanët aktual janë njerëz të

vegjël të cilët kanë ardhur të kërkojnë lumturi në këtë planet të madh.

Qëndrimi i fundit është shembull i dhunës moderne, të cilin njeriu ia bën vetes meqenëse vetvetiu e dëmton potencialin e dhënë nga Zoti të intelektit dhe shpirtit duke pranuar pozitë të mjerueshme të nënshtruarit.

Vetëm njerëzit me qëndrim proaktiv mendor e plotësojnë përkufizimin e personaliteteve të fuqishme dhe e arsyetojnë qëndrimin e tyre në këto hapësira.

Mendimi përmbyllës

Shpesh dëgjojmë se baballarët i thërrasin sugareshat e tyre me “princesha ime”, apo barrat i thërrasin nusët e tyre “mbretëresha ime”. Kjo do të ishte në rregull, sepse njeriu kënaqet nga fjalët e mira, sikur pas këtyre fjalëve mos të qëndronte tentimi i mbulimit të mungesave dhe të mospërsosurive vetjake. Ky abuzim me femrën moderne i ngjanë asaj të lojës së shahut. Që ta kuptojmë ku qëndron abuzimi, do të theksojmë se ndër figurat e shahut vetëm një është femër – mbretëresha. Atë e pëlqejnë më së shumti kundrejt mbretit, i cili është statik, i ngathët dhe gjithnjë pas perdes, i mbrojtur nga topi, gjuetarët, kuajt, piunët etj. Mbretëresha nuk e ka këtë problem, asaj i

është dhënë liri e lëvizjes dhe veprimi, por pikërisht për këtë ajo është figura më e eksponuar dhe më e përfolur. Ajo i ngjanë femrës së zhveshur në publikale, së cilës i japin ndjenjën e vlerës së rrejtshme kuajt, topat dhe figurat e shumta. Mbretëresha është figura që më së shumti rrezikon dhe shpesh pëson, duke mos pritur fund të lumtur. Madje, lojërat më të famshme të shahut janë ato, në të cilat viktimizohen mbretëreshat për të krijuar epërsi në fushën e tabelës së shahut.

Komenti është i tepërt. Vetëm nëse plotësohen këto dhe kushte të ngjashme, fushata e zonjës Jozefina mund të ketë sukses.

Fusnotat:

- [1] Konventa mbi eliminimin e dhunës kundër femrës – Asambleja Gjenerale e KB më 1993.
- [2] M. Scott Peck, Ljudi laži, preveo Darko Milošić, Zagreb, 1999.
- [3] Disa autorë mohojnë shifrat e larta dhe pohojnë se numri i femrave të vrara në Evropë për periudhën në fjalë është shumë më e vogël.
- [4] Ulfe Azizussamed, Islami dhe Kristianizmi, botimi I, Prizren, 1991.
- [5] Mashkulli dhe grupi i meshkujve, të cilët lejojnë depërtimin e mashkullit tjetër në territorin e tyre, humbin burrërinë e tyre. Ndaj në këtë rast, më me rëndësi është dominimi se sa gjinia. Kjo ndodh edhe më botën shtazore etj.

QASJE

KOSOVA NË UDHËKRYQ

Faik Miftari

Prizren, Kosovë

Pas zgjedhjeve parlamentare dhe lokale të mbajtura kohë më parë, gjegjësisht me 17 nëntor 2007, Kosova tani do të ballafaqohet me dy sfida jetike të saj. E para, krijimi i qeverisë së re funksionale të Kosovës, nga



vota e lirë e qytetarit, si dhe ajo e dyta parësore apo kruciale, rrrumbullakimi apo finalizimi i statusit politik të Kosovës.

Tek sfida e parë, lideri i PDK-së Hashim Thaqi, si kryeministër i ardhshëm i Kosovës, fitues i zgjedhjeve të 17 nëntorit në Kosovë, me të vërtetë do të ballafaqohet me çështjet më të rënda gjatë karrierës së tij politike, i cili duhet medoemos të tregojë pjekuri politike, urtësi, diplomaci, strategji, guxim, dhe mbi të gjithë punë të pandërprerë natë e ditë për të qeverisur dhe menaxhuar Kosovën në krye të qeverisë e cila do të jetë që në start e “bombarduar” si në aspektin politik, njashtu edhe atij ekonomik e social. Edhe pse do të jetë i sugjeruar nga faktori ndërkombëtar, që në qeverinë e

tij, të përfshijë një spektër më të gjerë politik aktual, përkundër çastit dhe momentit historik në të cilin gjendet Kosova, kjo për të do të jetë shpatë me dy tehe, pasi që në njërin anë do të jetë i detyruar të udhëheq me një qeveri, jo sipas dëshirës, por sipas sugjerimit, e cila qeveri do të mund të jetë irracionale dhe jo e logjikshme për skenën aktuale politike kosovare dhe raportit të forcave që janë momentale, por me të vetmen detyrë të implementimit të statusit të përcaktuar të Kosovës.

Në anën tjetër, kjo qeveri e formuar nuk do të jetë e efektshme për të menaxhuar dhe për të përmirësuar krizën ekonomike dhe sociale me përmasa të mëdha, e cila do të reflektohet haptas në sipërfaqe, menjëherë pas përcaktimit të statusit politik të Kosovës. Edhe pse kjo qeveri e formuar do të jetë plotësisht legale në njërin anë, por në anën tjetër do të jetë me një legjitimitet tejet të zbehur, pasi që atë e kanë votuar vetëm 40% të elektoratit nga numri i tërësishëm i elektoratit me të drejtë vote në Kosovë. Por në sistemin demokratik edhe mosdalja në votime apo bojkoti i pjesshëm i tij, është një e drejtë themelore e votuesit që nuk merr pjesë në votime, njëjtë sikur edhe i atij që del në votime.

Sfida e dytë me të cilën Kosova do të ballafaqohet gjatë ditëve dhe muajve të ardhshëm do të jetë përcaktimi, po apo jo, përfundimtar i statusit politik të saj. Në momentin që jam duke shkruar këtë analizë, është duke u mbajtur në Baden të Austrisë cikli përfundimtar i bisedimeve shtesë 120 ditore. Edhe pse nuk pritet ndonjë rezultat spektakular për ndonjë kompromis të mundshëm eventual të palëve negociuese Prishtinë-Beograd, në prani të treshes ndërkombëtare, është e udhës që të përfundojë edhe ky cikël bisedash të tej zgjatura gjer më 10 dhjetor, ditë e cila përfundon me dorëzimin e raportit të treshes së caktuar nga Grupi i Kontaktit sekretarit të përgjithshëm të OKB-së Ban Ki Mun. Për ne shumë më e rëndësishme është se çfarë do të përmbajë raporti i treshes së dorëzuar sekretarit të përgjithshëm të OKB-së dhe se çfarë do të propozojnë apo sugjerojnë ata për më tutje lidhur me statusin politik të Kosovës. Pas 10 dhjetorit Kosova do të ketë një rrugëtim të gjatë me sfida të shumta dhe të papritura, me plot opsione, duke mos e përjashtuar edhe atë luftarak. Edhe pse është plotësisht e qartë se në Këshillin e Sigurimit të OKB-së nuk do të mund të kalojë kurrfarë zgjidhje për Kosovën, duke marrë parasysh veton ruse, qëndrimi rus i cili edhe më tutje është apriori kundër çfarëdo zgjidhjeje për Kosovën në rast se nuk është i pajtimit me të edhe

Serbia, Kosova do të duhej patjetër të kalojë në një rrugë, jashtë KS të OKB-së drejtë pavarësisë së saj.

kryeministrin e Kosovës z. Hashim Thaqi i cili do të duhej të jetë në nivelin e pozitës dhe detyrës që e ka.

Në rast se gjatë luftës së Kosovës së vitit 98-99 Kosova dhe populli shqiptar i saj ka qenë i papërgatitur me opsionin e luftës dhe i pa udhëzuar nga lidershpi politik i atëhershëm, në këto çaste vendimtare historike për popullin shqiptar dhe Kosovën në veçanti, nuk guxon të gjejë të pa përgatitur dhe të pa udhëzuar nga lidershpi politik aktual i saj, mos dhashë Zoti, edhe me kërcënimet luftarake të Serbisë ndaj Kosovë.

Në përfundim të kësaj qasjeje, të gjithë shqiptarëve që gjenden në Shqipëri, iu uroj dhe ju përgëzoj, 28 nëntorin ditën e pavarësisë së Shqipërisë, ndërsa të gjithë shqiptarëve jashtë Shqipërisë, në trojet etnike shqiptare si dhe të gjithë shqiptarëve tjerë kudo qofshin ata, ditën e Flamurit, me dëshirë që vitin e ardhshëm ditën e Flamurit ne kosovarët ta festojmë, dhashë Zoti, në Kosovën e pavarur.



Para se të bëhet shpallja e pavarësisë së Kosovës, nënkuptohet në koordinim të plotë me faktorët kryesor ndërkombëtar që e mbështesin këtë ide, të gjitha institucionet e Kosovës duke u nisur që nga kuvendi, qeveria, presidenca, SHPK-së, TMK-së, UNMIK-u, KFOR-i dhe organet tjera gjegjëse, duhet të ndërmarrin të gjitha parapërgatitjet e duhura për të gjitha opsionet e mundshme që mund të ndodhin pas vendimit për shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Pa i kryer të gjitha përgatitjet e duhura, dhe se populli shqiptar me kohë të njoftohet paraprakisht dhe të jetë i gatshëm për çdo opsion të mundshëm, duke mos përjashtuar edhe opsionin luftarak, nuk duhet të ndërmerren hapa të pamatura dhe pakoordinuara më parë. Barra kryesore do të bie mbi

Mbetet të përkujtoj kryeministrin e ardhshëm të Kosovës z. Hashim Thaqin me një thënie të urtë profetike “mos lejo kurrë që gjarpri të të kafshojë dy herë nga gropa e njëjtë”.

Mbetet të përkujtoj kryeministrin e ardhshëm të Kosovës z. Hashim Thaqin me një thënie të urtë profetike “mos lejo kurrë që gjarpri të të kafshojë dy herë nga gropa e njëjtë”.

VËSHTRIM

SI T'I SHËRBEJMË ISLAMIT?

- Islamit mund t'i shërbeni duke poseduar një vendim të drejt dhe qëllimshëm, për arsye se Allahu xh.sh. do të të shpërblejë për veprën e cila është kryer vetëm për Madhërinë e Tij. Edhe në qoftë se vepra e kryer radhitet në rangun e punëve të vogla, Allahu përsëri do të të shpërblejë. Kur devotshmëria e sinqertë të bëhet tipar dhe shprehi e vazhdueshme e lutjeve dhe përlësisë së njeriut, sado të vogla që të duken ato për syrin e bërësit, megjithatë në syrin dhe peshoren e Krijuesit tonë të Madhërisëm ato do të peshojnë shumë, si rrjedhojë, Allahu i Plotfuqishëm robit të Tij mëkatar do t'i fal mëkatet e mëdha si rezultat i këtyre veprave të mira të kryera në mënyrë të vazhdueshme.
- Islamit mund t'i shërbeni duke njohur të drejtën dhe duke e pasuar atë. Rruga e drejtë do të thotë pasim i gjurmëve të Pejgamberit tonë të fundit Muahmmedit [alejhisselam], gjatë kësaj metode duhet të kihet parasysh edhe metodologjitë e thirrjes (da'wetit). Në këtë pikë assesi nuk duhet munguar durimi i vazhdueshëm, prandaj, duhet të tregojmë mirësi dhe dhembshuri ndaj njerëzve, për arsye se shumë prej tyre janë duke vuajtur nga sëmundjet e mëkateve.
- Fesë Islame mund t'i shërbejmë duke e vënë atë nga më të parat, me fjalë tjera, duke i dhuruar asaj prioritet para çdo interesi personal dhe dëshirë vetjake, arrijmë që t'i ofrojmë shërbim të merituar. Shërbimi ynë ndaj fesë do të thotë: të japim më të çmueshmen që kemi në pronësi; para, sakrificë, kohë, mendime, etj. A nuk keni vërejtur simpatizuesit e futbollit dhe ragbit se sa shumë i kushtojnë kohë dhe shpenzojnë për sportin e tyre të dashur. Kur është fjala për Islam, duhet ta kesh në vëmendje maksimumin që duhet dhënë në drejtim të tij.
- Duke ndjekur gjurmët e dijetarëve, thirrësve dhe reformatorëve Islam, jemi në gjendje më të mirë t'i ofrojmë ndihmë të madhe fesë sonë islame. Vlen të spikatet se gjatë këtij misioni, duhet të qëndroni stoik, të durueshëm dhe të pajtoheni me lodhjen dhe rraskapitjet që do t'u përcjellin gjatë misionit thirrës. Kjo vërtetë është një punë dhe sakrificë mjaft e madhe të cilën Pejgamberët e kryen me përpikëri, e me vonë edhe ndjekësit e gjurmëve të tyre.
- Islamit mund t'i ndihmojmë duke iu shmangur përtacisë, dembelisë, dobësisë dhe plogështisë, për arsye se kjo fe është fe e ambicieve, stimulimit dhe kurajës. Ajo që më se shumti dëmton imazhin e Islamit, është përtacia dhe mosdija apo injoranca.
- Islamit mund t'i shërbejmë duke lidhur zemrat tona me Allahun e Madhërisëm, duke lexuar lutje dhe duke falur namaze në mënyrë që të bëhemi nga pendestarët. Ky sukses mund të arrihet duke qenë këmbëngulës në leximin e Kur'anit vazhdimisht. Asgjë nuk ka më të dobishëm se sa spastrimi i zemrës dhe freskimi i shpirtit, prandaj duke e bërë atë me aktive dhe me energjike kështu që asnjëherë nuk do të ndiej lodhje apo mërzë, në fakt ajo do të jetë me përkushtuese në përkujtimin dhe përmendjen e Allahut duke iu afruar Atij më afër me namaze obligative dhe vullnetare (nafile).
- Ju mund t'i shërbeni Islamit duke formuar lidhje të forta me dijetarë të sinqertë, të cilët praktikojnë atë që flasin, me njerëz të sinqertë të cilët në çdo moment mbrojnë fenë dhe principet islame. Marshimi nën flamurin e tyre dhe pasimi i tyre është mjaft i dobishëm.
- Islamit mund t'i ofrojmë shërbim duke organizuar kohën ashtu si duhet. Kemi punë të cilat duhet kryer për çdo ditë, po ashtu punë dhe obligime të tjera që lypsen për t'u përfunduar për çdo javë, muaj apo për çdo vit, f.v. njerëzit të cilët i takojmë për çdo ditë, duhet t'i thërrasim në Islam, kjo duhet praktikuar edhe me ata të cilët takohemi një herë në javë. Nganjëherë kemi edhe tubim familjar të përmuajshëm, apo ndonjë konferencë vjetore, apo udhëtim për në haxh, në të gjitha këto manifestime mujore dhe vjetore, duhet shfrytëzuar rastin që t'i shërbejmë islamit duke i ftuar të pranishmit në besimin e pastër islam. Fesë Islame mund t'i shërbejmë duke qëndruar gjithmonë në krahun e saj; kur ngrihemi, të ngrihemi për hir të Islamit, kur të ecim, të jetë për Islam, kur të mendojmë, të mendojmë për këtë fe, kur të japim diçka, të bëhet për hir të Islamit, kur të ulemi po ashtu të ulemi për Islam.

Nga gjuha angleze: Feim Dragusha
Marrë nga: [\[www.muslimaccess.com\]](http://www.muslimaccess.com)

VËSHTRIM

DIALOG ME QIRIUN

Redi Shehu

Ka kaluar një kohë pothuaj e harruar kur në shtëpitë dhe ambientet tona të përditshme, energjia elektrike ishte prezente gjatë gjithë kohës. Një kohë e cila në koshiençën e brezit të ri është e pakuptimtë për arsye se adoleshentët e sotëm u rritën me mungesën e energjisë dhe kjo u kthye në një natyrshmëri për ta, në një mënyrë jetese e cila çliroi gjygjërit e tyre nga malli që kishin për çdo ndriçues tymosës.

Ka pothuaj rreth dy dekada që listës së domosdoshmërive shtëpiake i është shtuar edhe qiriun, apo ndriçuesat të formave të ndryshme përfshi edhe ato me “bubullima” siç janë gjeneratorët. Një pjesë e mirë e jetës sonë kaloi dhe po kalon duke dialoguar me qiriun e radhës i cili në fillim krenar, i drejtë, optimist, i sapodalë nga qesja, mundohet të hedhë pak dritë anemike në një errësi të pakompromis, por që pastaj pesimist në shkrirje e sipër, ngjyros trishtueshëm një ardhmëri të varfër infrastrukturore energjetike.

Ky qiriun jonë i kohëve moderne, ndryshe nga ai i Naimit, po shkrihet gjithmonë e më tepër, ndërkohë që ndriçimi i tij po bëhet gjithmonë e më i vështirë. Nëse ai i Naimit ishte e vetmja mënyrë për të parë botën natën, sot ky qiriun ynë, i prodhuar më së shumti me një teknologji që për ironi kërkon energji

elektrike, konceptohej si një zgjidhje emergjente për periudha të shkurtra kohe në raste kur rryma elektrike të çalltiste dhe të ikte. Por ja, që nuk paskësh qenë kështu. Si një duel për jetë a vdekje, qiriun i sotëm i ka shpallur luftë prizës elektrike, e cila duket e dorëzuar pa kushte duke i dhënë gjithmonë e më tepër terren këtij të fundit.

Një largim prej dekadash nga një energji e pandërprerë dhe zhytja në një errësi të gjithnjë e

shpërthimin drejt një bumi ekonomik, por gjithashtu e udhëheq drejt një mpirje intelektuale duke forcuar gjithnjë e më shumë idenë e paaftësisë, së pari për të përzgjedhur dhe së dyti për të menaxhuar situata të cilat fqinjët tanë i kanë kataloguar si ilustrime në librat e historisë.

Periudha jonë më e “suksesshme” për menaxhimin e



më tepër bën njëkohësisht që edhe kërkesa për nivelin e jetesës të mbetet në kufijtë e emergjencës.

Dialogu me qiriun apo shpesh me rubinetet që gjatë verës “agjërojnë” gjithnjë e më tepër, e largon idealin e një populli për të pasur një jetë më të mirë dhe për të menduar për një zhvillim më të qenësishëm, e kufizon atë në probleme të cilat e zvarrisin drejt vorbullave marramendëse imediate, emergjente. E paralizojnë iniciativën e tij,

energjisë elektrike daton me festën e madhe të elektrifikimit të vendit gjatë regjimit komunist. Por si çdo pjesë e ideologjisë komuniste edhe kjo zgjidhje rezultoi të ishte e cekët, miope, pa perspektivë për arsye se ishte konceptuar në shërbim të proletarit që në të njëjtën kohë nuk ishte konsumator sepse pasuria e vetme që kishte ishte vetvetja.

Me ndërrimin e strukturës

shoqërore si çdo element i sistemit komunist edhe energjetika u përball menjëherë me një krizë të befasishme, për arsye se ai teli i hollë proletar i shtrirë si përçues energjie në çdo cep të vendit, ishte i pafuqishëm të furnizonte me energji kërkesën gjithnjë e në rritje të konsumatorit të ri kapitalist shqiptar por edhe se burimet energjetike ishin konceptuar në këtë funksion. Është pikërisht në këtë periudhë që dialogu ynë me qiriun fillon për të mos pasur një fund ende.

Në të vërtetë i ashtuquajturit tranzicion, që për nga kohëzgjatja më shumë i ngjan një status-quo-je, shënon edhe fillimin e shumë dialogeve tona me gjithçka që konsiderohej si emergjencë, por që më vonë u kthye në një mënyrë jetese, në një përditshmëri të natyrshme larg shqetësimit dhe përpjekjes për ndryshim.

Strategjitë palë palë të qeverive që vijnë e shkojnë nuk rezultuan të ishin largpamëse dhe zgjedhëse të problemit. Ajo që lidhshpiti politik në këta pothuaj dy dekada i mungoi, ishte hartimi i një masterplani kombëtar konsensual për energjinë. Një platformë dhjetra vjeçare e cila doemos duhej të kishte konsensus gjithpartiak. Tek ne nuk është për t'u habitur fare, kur gjëra të tilla kaq të rëndësishme arroheshin me gjoja zgjidhje mediokre.

Një popull që si pa dashje u bë ekspert liqenesh e ujërash, shirash dhe rrebeshesh. Një dashuri e madhe në mesin e shqiptarëve lindi për përmbytjet. I gjithë zhvillimi kombëtar i yni varej nga fryrja dhe shfryrja e lumenjve. E gjithë kjo padyshim vinte nga mungesa e një vullneti

“Ka pothuaj rreth dy dekada që listës së domosdoshmërive shtëpiake i është shtuar edhe qiriu, apo ndriçues të formave të ndryshme përfshi edhe ato me “bubullima” siç janë gjeneratorët. Një pjesë e mirë e jetës sonë kaloi dhe po kalon duke dialoguar me qiriun e radhës i cili në fillim krenar, i drejtë, optimist, i sapodalë nga qesja, mundohet të hedhë pak dritë anemike në një errësirë të pakompromis, por që pastaj pesimist në shkrimje e sipër, ngjyros trishtueshëm një ardhmëri të varfër infrastrukturore energjetike.”

për ta zgjidhur si problem. Ky i joni nuk ishte problem implementimi, as edhe financiar, problem mbetej armiqësia jonë ndaj zgjidhjes së situatës.

Përgjegjësia më e madhe mbetej dhe mbetet ndaj qeverive të kaluara, por edhe ndaj kësaj aktuale që në shumë raste shtynte pa dobi implementimin e zgjidhjeve, por edhe komercializimin apo privatizimin e KESH. Aq sa përgjegjëse janë qeveritë socialiste për mos zgjidhjen e problemit, po aq përgjegjëse është edhe qeveria demokratike, që si rastësisht fillimin e punimeve të veprave energjetike si tecet apo edhe parqet energjetike, i shtyn në atë mënyrë që të mbarojnë pikërisht gjatë fushatës së ardhshme elektorale. Një komercializim i pushtetit në dëm të zgjedhësve. Do ishte më mbarë dhe më e sinqertë nëse politika jonë dhe

lidhshpiti i saj të përcaktonte kufijtë e luftës politike, të cilat nuk duhet të prekin çështje konsensuale të zhvillimit, prosperitetit dhe sigurisë kombëtare. Nëse një gjë e tillë nuk bëhet, atëherë kemi të gjithë të drejtën të mendojmë se elitës politikbërëse shqipëtare pak ose aspak i bëhet vonë. Nëse tenderët e Kesh-it për blerje energjie janë më të lakmueshme se një zhvillim infrastrukturor energjie me parametra bashkëkohorë dhe nëse lufta politike nuk tregon mëshirë për burimin e jetës, energjinë, atëherë nuk mbetet gjë tjetër por vetëm që për këto dekada që vijnë, në mesin e errësirës, të imagjinojmë se çfarë ndryshimi ka drita e qiriut me atë të energjisë bërthamore.

Gazeta Start
Www.gazetastart.com

PARAGJYKIME

MBYLLNI GJYQET E INSPEKTIMEVE

Aid el-Karni

Kurrsesi nuk do të jeni në gjendje t'i shpëtoni klasifikimit të njerëzve dhe gjykimeve miope të tyre edhe nëse jeni në ndërtesa të fortifikuara. Po që se flet, shkruan, prezanton, apo mban ligjëratë, dije se njerëzit do të ngritën e do të klasifikojnë ty; nëse je student, lavdëron mendimet e dijetarëve dhe i bart mendimet e tyre tek te tjerët, do të quajnë **'imitues fanatik'**; e nëse merr argumentet dhe ua argumenton me tekste/citate, do të quajnë si **'dhahirij i ashpër'** (drejtim që bazohet në tekstet sipërfaqësore); e nëse ngrit zërin tënd duke folur ashpër dhe duke mohuar disa kontradikta, do të të quajnë **'harixhij'** (fraksioni havarixh d.t.th të dalur nga burimet e pastra islame); nëse shpreshton në përgëzime dhe ua rikujton njerëzve 'faljen e Zotit' gjegjësisht mëshirën e Tij dhe ua hap atyre derën e shpresës drejt pendimit, atëherë ata do të thërrasin ty si **'murxhi'** (fraksion fetar); e nëse shoqërohesh me njerëz autoritativ dhe flet shumë butë me ata, do të thirrsh nga të tjerët si **'dijetar lajkatar i sunduesit'** me fjalë të tjera, do të quajnë si një dijetar që i shkon për shtati liderit apo sulltanit; nëse shkruan për ndokënd dhe sjell diç nga perëndimi, atëherë do të quajnë ty **'liberal'**; nëse flet për civilizimin apo qytetërimin dhe për eksperiencat

e tjerëve, do të atribuohesh si **'shekullar-laik'**; e nëse je kundër qeverisë dhe udhëheqësve, atëherë do të quajnë ty **'ihvan'** (lëvizje e vëllezërve musliman e themeluar në Egjipt); nëse e përmend miqësinë dhe armiqësinë, do të thirrsh si **'admirues i qejfeve'**; e nëse ia shpreshton shumë përgëzimeve dhe ua kthen shpinën të këqijave (nuk flet për to), atëherë do të quajnë ty **'teblig'** (Lëvizje e njohur thirrëse – tablig -, e themeluar për herë të parë në Indi); e nëse e kundërshton udhëheqësinë (aktuale), atëherë do të quajnë **'emancipues'**; e nëse thërret në metodologjinë e selefëve, respektivisht në largimin nga gjërat politeiste dhe risive, do të quajnë ty **'vehabij'**; e nëse i shpreshton lëvdatat profetike, atëherë do të quajnë ty simpatizant të **'sufizmit'** (mistik - njerëz të larguar nga kënaqësitë e kësaj bote)...

Për ta argumentuar atë që thamë më lart, do të përmendja disa nga librat dhe punimet në të cilat është stërfolur për mua; për një varg të poemës më akuzuan, tjetri më akuzoi dhe më quajti sufi-mistik për një shprehje që e thash në një kasetë, i treti tha se jam nga havarixhët, ngase unë paskam një poemë kur isha nxënës në shkollë të mesme, poema me titull: 'Lëri referencat dhe dil', qëllimi im ishte: O, ti dijetar, dil te njerëzit si mësues dhe edukues, e mos u mjafto vetëm me perceptimin e referencave. Komenti i tij ishte:

Dil apo largohu nga (pushteti i) udhëheqësit. Tjetri tha se unë jam murxhi, ngase unë po shpreshtoja duke përmendur pendimin dhe mëshirën derisa ia paskam lehtësuar njerëzve mëkatet.

Unë nuk po e mohoj kurrsesi ekzistimin e këtyre drejttimeve, lëvizjeve, ideve, por, unë nuk po mundem ta pranoj atë që kanë emëruar atë për vetvete; që të jene gjykatës ndaj robërve të Zotit, duke klasifikuar njerëzit për çdo thënie, poemë, ligjëratë apo libër të tyre.

O njerëz, mbyllni gjyqet e inspektimeve nga veshët tuaj, ndaluni nga zbulimi i të metave të të tjerëve dhe nga hetimet në mendjet e juaja, ngritni varjet që ua keni atribuuar të tjerëve.

O ju dijetarë dhe ju thirrës, ruani gjuhët e juaja nga zhytja në atë që e ka ndaluar Zoti, o ju shkrues, futni në kallëpe pendët e juaja e mos shpifni, mos shtrembëroni, mos ofendoni as mos përqeshni, mos gjykoni përpos nëse keni argumente të qarta, ashtu siç shihet dielli në ditën e kthjellët. Ndërsa paragjykesit, iluzionistët dhe dyshuesit janë me shpirtra të sëmurë, me vlera të varfra, dhe pa ndërgjegje...

Nga gazeta saudite: **Sherk El-Eusat**

Përkthim i shkurtuar nga gjuha arabe

Përshtati në gjuhën shqipe: **Ejup Haziri**

THIRRJE

THIRRJE PËR N'XHENNET

Zuhdi Hajzeri

Kairo

A dëshiron të jesh afër All-llahut xh.sh.?

Pejgamberi a.s. thotë: **“Robi më së afërmi me Zotin e tij është kur ai është në sexhde pra lutuni shumë”** (Transmeton Muslimi).

A dëshiron shpërblimin e një Haxhi ?

Pejgamberi a.s. thotë: **“Umreja në Ramazan është e barabartë me një haxh ose si haxhi me mua”** (Hadith autentik).

A dëshiron një shtëpi
Pejgamberi a.s. thotë:
**ndërton një Xhami
llahut, All-llahu ia
një në xhennet si
ajo”** (Transmeton

A dëshiron ta fitosh
All-llahut xh.sh.?

Pejgamberi a.s. thotë:
**llahu është i kënaqur
Tij kur ai hanë
dhe falënderon Atë
falënderon prapë
Atë”** (Transmeton

A dëshiron të
duatë-lutjet tua?

Pejgamberi a.s. thotë:
**mes ezanit dhe
refuzohet (nuk
kthehet)”** (Transmeton

A dëshiron të kesh
agjërimin të një vitit të

Pejgamberi a.s. thotë: **“Agjërimi i tri ditëve të çdo muaji ka vlerën e agjërimin sa të gjithë kohës”** (Hadith autentik).

A dëshiron të mira sa kodrat?

Pejgamberi a.s. thotë: **“Kush prezanton në xhenaze derisa t'i falet namazi i xhenazes për të ka një “Kirat”, e kush prezanton derisa të varroset për të ka dy “Kirat”, i është thënë çka është “Kirat”? ka thënë sikur dy kodra shumë të mëdha”** (Hadith autentik)

A dëshiron të jesh në shoqëri me Pejgamberin a.s. në xhennet ?

Pejgamberi a.s. thotë: **“Unë dhe ai që përkujdeset për jetimin sikur këta dy jemi në xhennet dhe ka bërë me shenjë me gishtin tregues dhe të mesëm”** (Transmeton Buhariu)

A dëshiron shpërblimin e luftëtarit ose falësit të namazit ose agjëruetit në rrugën e Zotit?

Pejgamberi a.s. thotë: **“Ai që shpejton në kërkim të ushqimit ose i varfëri janë sikur luftëtari në rrugën e All-llahut ose si falësi i namazit ose agjërueti që nuk hanë”** (Hadith autentik).



në xhennet?

**“Kush
për hir të All-
ndërton atij**

Muslimi).
kënaqësinë e

**“Vërtetë All-
me robin e**

dhe kur pinë

Muslimi)
pranohen

**“Duaja në
ikametit nuk**

Ebu Dawudi)
shpërblimin e
plotë?

A dëshiron ta garantoj Pejgamberi a.s. xhennetin ?

Pejgamberi a.s. thotë: **“Kush më garanton atë çka ka në mes të nofullave dhe në mes të këmbëve ia garantoj xhennetin”** (Hadith autentik).

A dëshiron që të mos ndërpriten të mirat tua edhe pas vdekjes?

Pejgamberi a.s. thotë: **“Kur të vdes biri i Ademit ndërpriten të mirat e tij përveç nga tri punë; Sadakaja (e rrjedhshme), dituria e cila sjellë dobi, apo fëmiu i devotshëm që bën dua për të-lutet për të”** (Transmeton Muslimi).

A dëshiron një thesar nga thesaret e xhennetit ?

Pejgamberi a.s. thotë: **“La Hawle We la Kuwete ila Bilah”** (Hadith autentik)

A dëshiron shpërblimin e një faljeje gjatë një nate të plotë ?

Pejgamberi a.s. thotë: **“Kush e fal namazin e Jacisë me xhemat sikur ka falur namaz gjysmën e natës, e kush e falë namazin e Sabahut me xhemat sikur ka falur namaz tërë natën”** (Transmeton Muslimi).

A dëshiron ta lexosh një të tretën e Kur'ani për një minutë të vetëm?

Pejgamberi a.s. thotë: **“Kulhuwallahu ehad) surja ihlas është sa një e treta e Kur'anit”** (Transmeton Muslimi).

A dëshiron të rëndohet peshorja yte e punëve të mira?

Pejgamberi a.s. thotë: **“Dy fjalë janë të lehta për gjuhën por të dashura për të Gjithmëshirshmin dhe të rënda në peshore e ato janë: subhanallahu we bihamdihi subhanallahi el-adhim”** (Transmeton Buhariu)

A dëshiron të shtohet rrizku-furnizimi yt dhe të të zgjatet jeta?

Pejgamberi a.s. thotë: **“Kush dëshiron t'i zgjerohet rrizku-furnizimi i tij dhe t'i zgjatet jeta e tij, le ti përmirëson marrëdhëniet me të afërmit e tij.”** (Transmeton Buhariu)

A dëshiron që All-llahu ta dëshiroj takimin me ty?

Pejgamberi a.s. thotë: **“Kush dëshiron takimin me All-llahun, All-llahu e dëshiron takimin me të.”** (Transmeton Buhariu)

A dëshiron që të të ruaj All-llahu ty?

Pejgamberi a.s. thotë : **“Kush e falë namazin e sabahut është nën mbrojtjen e All-llahut”** (Transmeton Muslimi).

A dëshiron të të përshëndetë All-llahu ty ?

Pejgamberi a.s. thotë : **“Kush më (dërgon salavat) përshëndet mua një herë All-llahu e përshëndet atë dhjetë herë”** (Transmeton Muslimi).

A dëshiron që të të ngritë All-llahu ty?

Pejgamberi a.s. thotë: **“Nuk ka person që është modest për hir të All-llahut e të mos e ngritë atë All-llahu”** (Transmeton Muslimi).

A dëshiron të jetë largësia në mes teje dhe zjarrit sa ecja shtatëdhjetë vite?

Pejgamberi a.s. thotë: **“Kush agjëron një ditë për hir të All-llahut e bënë All-llahu që largësia në mes tij dhe zjarrit të jetë shtatëdhjetë vite larg.”**(Hadithi autentik).



PSIKOLOGJI

PROBLEMET FAMILJARE DHE NDIKIMI I TYRE NË PSIKIKËN E FËMIUT

Ajsel Polaku

Ndër psikologët ekziston një pajtim i përgjithshëm se roli i familjes, qoftë në formimin e personalitetit, qoftë në shëndetin fizik dhe shpirtëror, është me rendësi të jashtëzakonshme. Familja normale, në të cilën gëzon dashurinë prindërore dhe ndjenjën e sigurisë, është kusht i domosdoshëm për zhvillimin e drejtë të personalitetit.

Në mesin e çdo familje, problemet të cilat kanë mundësi të ndodhin, apo shpesh dhe ndodhin, ndikojnë shumë në psikikën e fëmijës, e sidomos të atyre që janë në fazën e fëmijërisë të hershëm. Prania e parë e tij në një konflikt mes prindërve mund të jetë shumë traumatike, shembull mjaft i mirë është një vajzë 8 vjeçare e cila u dërgua nga familja e saj tek Prof. Dr. Atalay Yorukoglu për disa ankesa; humbja e shpeshtë në mendime, frika nga errësira, etj..

Nga bisedat e bëra me familjen e vajzës së sjellë për ankesat e lartpërmendura u përmend se: një mesnatë vajza është zgjuar nga një zhurmë e madhe, disi e trishtuar kur pa polemiken në mes të prindërve kishte filluar të qajë, pastaj pa dëshirën e saj është dërguar në shtrat dhe më pastaj e ka zënë gjumi. Edhe pse më asnjëherë nuk është përsëritur ajo polemikë, vajza gjithmonë frikësohej se një ditë prindërit e saj do të ndaheshin, dhe nuk

bënte gjumë asnjëherë. Ajo duke u arsyetuar “frikohem” çdo mbrëmje insistonte që të flinte me prind, me këtë gjest është munduar që t'i pengojë grindjet e ardhshme në mes të prindërve. Këtë frikë ia kishte shtuar edhe më tepër kur shoqja e saj e klasës i kishte treguar se prindërit e saj ishin ndarë kohë më parë.

Ndjenja më e fshehur tek fëmijët në grindjet e pandërprera të prindërve është frika që do të jenë në mes dy prindërve, veçanërisht mendimet se vet ata janë shkaktarë për grindje. Në

nga njëra anë. P.sh.: Një nënë e cila mendon se iu është bërë padrejtësi shpreson ndihmë nga fëmijët kundër babait, e nganjëherë edhe duke tepruar kërkon që fëmija të luaj rolin e gjyqtarit në mes tyre. E s'ka dyshim se kjo e bën fëmijën të mendoj, të futet paksa sikur në një rrugë pa dalje, sepse duhet të bëj një zgjedhje në mes atyre që i donë më së shumti, e kjo zgjedhje njëherën palë do ta lëndojë. Vlen ta përmendim edhe atë se pas grindjeve në shumicën e rasteve, fëmija i cili fajësohet me fjalët “se sikur ti të



qoftë se mendohet se shumica e grindjeve të çifteve shkaktohet për arsye të fëmijëve e pastaj ata e shndërrojnë në çështje personale, është shumë më lehtë të kuptohet brenga e fëmijëve në këtë aspekt. E që në disa raste dhe vet fëmija futet në këto lloj grindjeje dhe detyrohet të anoi

mos bëheshe i padëgjueshëm dhe të mos bëje probleme babai s'do të ishte bërë nervoz dhe nuk do ta kishte shprehur mllefën e tij tek unë”, tek këta fëmijë shfaqet :

- ◆ ndjenja e hidhërimit,
- ◆ pastaj se janë të shkelur, dhe

- ◆ ngulitet në mendimet e tyre se ata nuk janë të mirë.

Fëmijët të cilëve shpesh u bëhen fajësime dhe shqetësohen, ata bëhen më:

- agresiv,
- problema, dhe
- bëjnë vepra të papëlqyeshme në mënyrë që ta masin dashurinë e prindërve ndaj tyre.



Fëmija pret që t'i shfaqet çasti më i volitshëm që të nxjerr diçka për vete. Duke përdorur babanë kundër nënës, apo anasjelltas, ai përpiqet që t'i arrijë qëllimeve të veta.

Fëmija, duke parë dhe jetuar në familje mëson:

- dashurinë;
- urrejtjen;
- mirënjohjen.

Dashuria, ndërgegjja, urrejtja nuk janë gjera që fitohen nga këshillat, por këto ndjenja zhvillohen sidomos duke marrë shembull nënën dhe babanë. Nuk ekziston ndonjë rregull që para fëmijës gjithmonë të jemi të buzëqeshur apo gojëmbël.

Fëmija duhet të njeh edhe ndjenjat e tjera që janë njerëzore si: nervozen, hidhërimin etj.

Por, fëmija duhet të mësojë se si të frenohet, dhe si në mënyrë njerëzore t'i shpreh ato. Një baba që nuk e kufizon agresivitetin, apo një nënë që shpreh çdoherë vetëm nervozë nuk mund ta mësojë fëmijën që të jetë i matur.

Nga ky shikim nuk është ashtu siç mendohet që debatet brenda familjeve të zhvillohen fshehurazi nga fëmijët sepse nuk mund të fshihen prej tyre shumë gjëra.

Për fëmijët nuk janë të rëndësishme cilat tema zhvillohen, por është e rëndësishme marrëdhënia në

mes prindërve. Mirëpo prapë se prapë s'është e pëlqyeshme në mes tyre të bisedohen tema sekrete.

Tema të cilat nuk devijohen dhe përfundojnë me marrëveshje për fëmijët janë të dobishme. Fëmija mëson

vetëbesimin pasi që shef se dashuria dhe marrëdhëniet nuk përfundojnë me shprehjen e mendimeve të papëlqyeshme. Tek familjet që çdo bisedë shndërrohet në konflikt, ndarje, ikja nga shtëpia, shkakton çrregullime të gjata psikike tek fëmijët.

Në një ambient familjar ku babai ka lidhje me të tjera, e shfrytëzon buxhetin familjar për kumar/bixhoz, përdor alkool, gjë kjo që e dëmton shumë shëndetin e babait padyshim se aty nuk ka gjallëri, e në këtë situatë fëmijët janë të: shqetësuar, të habitur dhe pa zgjedhje.

Fëmija fiton:
nervozë;
armiqësi, dhe
bëhet pesimist.

Mund të shkaktojnë probleme psikike në vete kaluese dhe të qëndrueshme; zbrit suksesin në mësim, çrregullime në sjellje. Ndërsa tek vajzat: bëhen më tepër frikacake dhe të merakosura në çdo çështje. Rriten duke u frikësuar nga martesat, mbesin në mes nënës dhe babait apo dëshirojnë të strehohen tek dikush tjetër, përderisa nuk kanë ku të mbështeten ju lëndohet ndjenja e besimit dhe fillojnë të dyshojnë nga dashuria e prindërve.

“Në mesin e çdo familje, problemet të cilat kanë mundësi të ndodhin, apo shpesh dhe ndodhin, ndikojnë shumë në psikikën e fëmijës, e sidomos të atyre që janë në fazën e fëmijërisë të hershëm.”

TEKNOLOGJI

UEBI I SË ARDHMES

Rexhep Kqiku

MCP, MCDBA, MCAD

Ishte fillimi i viteve të '90 kur filloi ti merr hapat e parë platforma ueb. Nuk është aspak "fer" që të bëhet një krahasim i fillimit të kësaj platforme me atë të ditëve të sotme. Në fillim uebi ishte një vend statik i cili përmbante disa faqe të thjeshta HTML. Mirëpo me interesimin e kompanive të ndryshme të biznesit ai filloi ta merr një kahe tjetër. Ky interesim qoi në zhvillimin e teknologjive të reja si XML, SOAP (Simple Object Access Protocol) etj., të cilat ndryshuan mënyrën e lidhjes së aplikacioneve dhe sistemeve në mes veti. Këto teknologji vazhdoi ti ndjek platforma ueb 2.0 e cila karakterizohet me fenomenin e blogjeve (blogs), wiki dhe rrjeteve shoqërore. Tash kur shumica e përdoruesve të internetit po e ndjejnë lehtësimin që ka sjell teknologjia 2.0, uebi po përgatitet për hapin e ardhshëm.

Tejkalimi i kufijve të tanishëm

Gjenerata e re e uebit do të karakterizohet me dinamizëm, interaktivitet dhe me aplikacione shumë fleksibile, të cilat jo vetëm që do t'i kalojnë kufijtë dhe mundësitë e uebit aktual, mirëpo do të jenë një kërcim serioz për Windows aplikacionet.

Aplikacion i pasur që nuhatë

Ueb aplikacionet e gjeneratës së ardhshme do të jenë shumë interaktive, do të kenë aftësi të përshtatën sipas qejfit të

përdoruesit, do të kenë një ndërfaqe të bukur dhe atë më të mirë se Windows aplikacionet. Këto aplikacione nuk do të kenë kurrfarë kuptimi nëse ato nuk e përkrahin mundësinë drag-and-drop që i lejon përdoruesit ta kostumizoi përmbajtjen dhe renditjen në aplikacion, gjithashtu menyja e right click (menyja e djathtë e miut) do t'i përkas aplikacionit ueb e kurrsesi sistemit operativ (shiko



Windows live mail). Përgjigja në kërkesa të përdoruesit duhet të jetë e shpejtë, e këtë e mundëson AJAX (Asynchronous JavaScript and XML) i cili lejon dërgimin e kërkesës së përdoruesit pa pasur nevojë që të kërkohet dhe të merret e tërë përmbajtja e uebit.

Ajo që duhet të kihet parasysh është se një ueb sajt me shumë animacione dhe shumë dizajn nuk mund të merret si aplikacion i së ardhmes, animacioni mund ta zbukurojë uebin,, por jo edhe ta bëjë të gjeneratës së re.

Aplikacion mendje hapur

Duhet ta dimë se teknologjia që bëri revolucion në 10 vitet e fundit janë ueb shërbimet (web services) dhe SOAP.

Aplikacionet e gjeneratës së ardhshme duhet të jenë të afta të bashkëbisedojnë me aplikacionet

tjera që nuk janë satelit të tyre, por ndoshta edhe konkurrent të tyre. Mënyra e komunikimit të tyre ndoshta do të caktohet nga një standard botëror. Aplikacioni i mençur në bazë të kërkesave të përdoruesit do të din të komunikojë me aplikacione tjera nëse informatat që i kërkon përdoruesi nuk gjenden në të. Gjithashtu aplikacioni duhet të jetë cross-browser, pra i punuar në atë mënyrë që të mos ketë kufizime në shfletues (browser).

Të dhëna dinamike

Ashtu sikur që e bëjmë kostumizimin e desktopit, ueb aplikacionet e ardhshme do të na mundësojnë që të dhënat që na duhen më së shumti t'i kemi afër gjithmonë dhe në çastin kur ato na duhen t'i kemi aty për aty. Aftësia tjetër që do të na japin këto aplikacione është ndarja (share) e përmbajtjeve të ndryshme me të tjerët gjithashtu edhe mundësia që t'i menaxhojmë privilegjet në këto përmbajtje për personat e caktuar (shiko Windows live sky drive).

Zhvillimi i kësaj platforme dhe evoluimi i saj gjithnjë e më shumë po e rrezikon windows platformën, përdoruesit gjithnjë e më shumë dëshirojnë që atë që e kanë në kompjuterin e tyre ta ndajnë me të tjerët. Nuk është jologjike të mendosh që me një të ardhme jo fort të largët sistemin operativ do ta kemi të instaluar në serverët e microsoft-it ose google-it dhe hard--disku do të jetë diçka e harruar.

PËRKTHIME

KOMENTIMI I SURES EN-NEBEE

Vijon nga numri i kaluar

Komentimi i sures En-nebee, nga ajeti 37-40

رَبِّ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَا بَيْنَهُمَا
الرَّحْمَنِ لَا يَمْلِكُونَ مِنْهُ خِطَابًا

“Zoti i qiejve e i tokës dhe çka ka ndërmjet tyre, që është mëshirues, të cilit nuk kanë të drejtë t’i bëjnë vërejtje.” (En-Nebee:37).


رَبِّ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَا بَيْنَهُمَا
الرَّحْمَنِ لَا يَمْلِكُونَ مِنْهُ خِطَابًا

“Zoti i qiejve e i tokës dhe çka ka ndërmjet tyre, që është mëshirues, të cilit nuk kanë të drejtë t’i bëjnë vërejtje.” (En-Nebee:37).

Allahu i Lartmadhëruar është Zot i çdo gjëje. Thotë Allahu i Madhëruar: **إِنَّمَا أَمْرُهُ أَنْ أَعْبُدَ رَبَّ هَذِهِ الْبَلَدَةِ الَّذِي حَرَمَهَا وَكَهَّ كُلُّ شَيْءٍ وَأَمْرُهُ أَنْ أَكُونَ مِنَ الْمُسْلِمِينَ**

“Unë jam urdhëruar ta adhuroj vetëm Zotin e këtij qyteti, të cilin Ai e bëri të shenjtë, se Atij i takon çdo send, dhe jam urdhëruar të jem prej besimtarëve të sinqertë.” (En-Neml:91).

Ai është Zoti i shtatë qiejve palë mbi palë, dhe Zoti i shtatë tokave ashtu siç është vërtetuar me hadith autentik nga Pejgamberi a.s. **وَمَا بَيْنَهُمَا** që do të thotë: Zot edhe i asaj çka është mes tokës dhe qiejve prej krijesave të mëdha siç janë yjet, retë, mjegullat, e tjera që e din njeriu, dhe shumë të tjera që nuk i din askush përveç Allahut të



Madhëruar.

Fjala e Allahut **لَا يَمْلِكُونَ مِنْهُ**

خِطَابًا

“të cilit nuk kanë të drejtë t’i bëjnë vërejtje”, atë ditë (dita e gjykimit) njerëzit nuk posedojnë të drejtë të flasin, vetëm kujt i jep leje Allahu i Madhëruar, e kjo është: “Atë ditë Xibrili dhe engjëjt qëndrojnë të rreshtuar”.

Meleku Xhibril **وَالْمَلَائِكَةُ صَفًّا**

“engjëjt qëndrojnë të rreshtuar” që do të thotë reshtë pas rreshti, ashtu siç është transmetuar në këtë hadith: “Zbresin Melaiket e qiellit të parë dhe i rrethojnë gjitha krijesat, pastaj Melaiket e qiellit të dytë rreshtohen pas Melaikëve të qiellit të parë, pastaj të qiellit të tretë, të katërtë, të pestë...” Kështu pra të radhitura në safe, nuk e di numrin e tyre askush përveç Atij që i ka krijuar i lartësuar qoftë Ai

(Allahu xh.sh.) (askush nuk flet pos atij që e lejon Mëshiruesi, dhe i cili e thotë të vërtetën). As melaiket e askush tjetër nuk do të flet. Thotë Allahu xh.sh.

يَوْمَئِذٍ يَتَّبِعُونَ الدَّاعِيَ لَا عِوَجَ لَهُ
وَخَشَعَتِ الْأَصْوَاتُ لِلرَّحْمَنِ فَلَا تَسْمَعُ
إِلَّا هَمْسًا

“e para të Gjithmëshirshmit ulen zërat e nuk dëgjohej tjetër pos një zë i ulët.” (Ta Ha:108). (Askush nuk flet pos atij që e lejon Mëshiruesi) As një fjalë askush nuk e flet pos atij që e lejon Allahu xh.sh. e ai flet ashtu siç është urdhëruar. **وَقَالَ**

“dhe i cili e thotë të vërtetën.” E thotë fjalën e vërtetë, fjalë që e kënaq dhe pajton Allahu xh.sh. e kjo është kur dikujt i pet e drejta nga Allahu që ai të ndërmjetëson, e ai flet aq sa i është dhënë e drejta. **ذَلِكَ الْيَوْمِ الْحَقُّ** “Ajo është dita e vërtetë”.

Kjo është dita e vërtetë që Ne u kemi lajmëruar për këtë, e vërteta është e kundërta e të kotës. Kjo është dita që në të del në shesh e vërteta, në këtë ditë gjykohet me drejtësi, kjo është dita që në të nuk bënë dobi malli e as evladi, vetëm ai që i ka ardhur Allahut me zemër të pastër.

“e kush dëshiron le të kthehet rrugës te Zoti i vet.” E ai që dëshiron të shpërblehet le të bënë punë të mira dhe me to të kthehet tek Allahu, e vepra të mira janë ato që është i kënaqte

me to Allahu xh.sh.

Fjala e Allahut xh.sh.

فَمَنْ شَاءَ اتَّخَذَ إِلَىٰ رَبِّهِ مَا بَا

“e kush dëshiron le të kthehet rrugës te Zoti i vet.” Këtë verset e ka kushtëzuar verseti tjetër ku thuhet: “Për atë nga mesi që dëshiron të gjendet në të vërtetën. Po ju nuk mundeni, por vetëm nëse dëshiron Allahu, Zoti i botëve!” Et-Tekwir:28-29)

D.m.th. ne mundemi të zgjedhim në disa çështje e këtë nuk e urren askush, mirëpo me gjithë këtë zgjedhja e jonë është me dëshirën dhe vullnetin e Allahut, pra gjithçka kthehet tek Ai. **“Po ju nuk mundeni, por vetëm nëse dëshiron Allahu, Zoti i botëve!”** Allahu çështjen e zgjedhjes e bëri të qartë në Librin e Tij, në mënyrë që mos t’i ipet shanse njeriut të mbështetët në forcën dhe dëshirën e vetë, por gjithherë duhet ta ketë parasysh se dëshira e tij është kushtëzuar me dëshirën e Allahut në mënyrë që njeriu gjithherë të kërkon udhëzim dhe mundësi prej Allahut në veprat të cilat i donë Allahu xh.sh. Nuk i takon njeriut të thotë: unë jam i lirë të veproj çka të dua dhe si të dua, i themi çështja është kështu pjesërisht, mirëpo është e lidhur dhe kushtëzuar me dëshirën e Allahut.

إِنَّا أَنْزَرْنَاكُمْ عَذَابًا قَرِيبًا

“Ne ua tërhoqëm juve (idhujtarëve) vërejtjen për një dënim të afërt”.

Ne u frikësua juve me dënim të afërte, ajo është dita e kiametit. Dita kiametit është afër edhe nëse ekziston kjo botë me mija vite me gjithë këtë dita e Kiametit është afërt.

“...njeriu nuk e di se kur do të vdes, ndoshta është gdhirë në mëngjes por nuk do ta arrin mbrëmja, e ndoshta e ka arritur mbrëmja e nuk e zë mëngjesi, për këtë është obligim i njeriut t’i përkushtohet veprave të mira, dhe ta shfrytëzon çdo shanse para se t’i kalon.”

Thotë Allahu xh.sh.: **“Ditën kur ta përrjetojnë atë, atyre (idhujtarëve) do t’u duket sikur nuk kanë jetuar më tepër se një mbrëmje ose një mëngjes të saj.”** (En-Naziat:46).

Dënimimi me të cilin Allahu na tërhoqi vërejtjen është afër, nuk ka mes dënimin dhe njeriut tjetër vetëm se vdekja. E njeriu nuk e di se kur do të vdes, ndoshta është gdhirë në mëngjes por nuk do ta arrin mbrëmja, e ndoshta e ka arritur mbrëmja e nuk e zë mëngjesi, për këtë është obligim i njeriut t’i përkushtohet veprave të mira, dhe ta shfrytëzon çdo shanse para se t’i kalon.

يَوْمَ يَنْظُرُ الْمَرْءُ مَا قَدَّمَتْ يَدَا

“në ditën kur njeriu (besimtar) shikon se çka i kanë sjellë duart e veta”. Çdo njëri do ta shikon se çka ka punuar me duart e veta, do t’i ipet libri i tij në të të shënuara punët e tija, e t’i thuhet: **“Lexo librin tënd, mjafton të jesh sot vetë llogaritës i vetvetes”.** (El-Isra:14). E atëherë nga trishtimi se çfarë sheh do të thotë jobesimtari: **“e jobesimtari thotë: “Ah, sa mirë do të ishte për mua sikur të isha dhe!”.** Do të thotë jobesimtari “ah i

mjeri unë sikur mos të isha krijuar, ah i mjeri unë sikur mos të isha ngjallur”. Ose kur t’i sheh kafshët kur Allahu të gjykon mes tyre pastaj ju thuhet: bëhuni dhe, e ato bëhen pluhur e dhe, jobesimtari shpreson të bëhet kafshë e të gjykohet me të sikur me kafshët. Fjala Allahut; **” كُنْتُ تُرَابًا sikur të isha dhe”** i ka tri kuptime: Ah i mjeri unë sikur mos të isha krijuar, ngase njeriu është krijuar nga dheu.

Ah i mjeri unë sikur mos të isha ngjallur, do me thëne, të isha dhe në barkun e varrit.

Kur ai do t’i sheh kafshët sesi gjykohe dhe pastaj ju thuhet bëhuni pluhur e dhe, ky shpreson të bëhet si kafshët pluhur e dhe. - Allahu e di më së miri –

Këtu përfundoi komentimi i kaptinës En-Nebee. Në te ka argumente dhe këshilla që e forcojnë imanin, e lusim Allahun që të kemi dobi prej saj ju dhe ne, si dhe ta bënë këshillë për zemrat tona, dhe shërim të shpirtit tonë, Ai është i Cili i pranon duatë.

FUND

Përktheu nga gjuha arabe:

Ardian Sejdiu

Libri: Xhuz’u Amme, Tefsiru Ibnu Uthejmin

PËRKTTHIME

ZBATIMI I KUR'ANIT NË JETËN TONË TË PËRDITSHME

Liza Abdullah

Vijon nga numri i kaluar

XVI

HIGJIENA VETJAKE

Të qenurit i pastër është jashtëzakonisht me rëndësi për jetën e njeriut, pasi edhe përhapja e shumë sëmundjeve është rezultat i rrobave të papastra. Në vazhdim do të sjellim një ajet kur'anor, i cili në mënyrë të qartë na mëson mbi pastërtinë dhe mënyrën e saj:

“O ju që besuat! Kur doni të ngriheni për të falur namazin, lani fytyrat tuaja dhe duart tuaja deri në bërryla; fërkoni kokat tuaja, e këmbët lani deri në dy zogjtë. Nëse jeni xhunubë, atëherë pastrohuni (lahuni)! Në qoftë se jeni të sëmurë, ose në ndonjë udhëtim, ose ndonjëri prej jush vjen prej vendit të nevojës, ose keni kontaktuar me gratë dhe nuk gjeni ujë, atëherë mësyjeni dheun e pastër e me të fërkoni fytyrat dhe duart tuaja (për tejemum). Allahu nuk dëshiron (me obligimin për abdest e larje) t’ju sjellë ndonjë vështirësi, por dëshiron t’ju pastrojë (prej mëkatëve), ta plotësojë të mirën e Tij ndaj jush e që t’i falënderoheni.” [Kur’an 5:6].

Ajeti i përmendur na porositë që pas kontakteve intime me gratë të pastrohemi, të pastrohemi pasi të kemi përdorur banjon. Të pastrojmë duart, bërrylat, fytyrat, t’i fërkojmë kokat dhe t’i pastrojmë këmbët, të gjitha këto pjesë

duhet të lahen para se të fillojmë faljen e namazit. Nga këto ajete gjithashtu mësojmë se dëshira e Allahut është që ne të jemi të pastër dhe që mos të na japë vështirësi. Nëse pyesim çfarëdo mjeku mbi vlerën dhe rëndësinë e të qenurit i pastër, ai patjetër do jetë në gjendje ta shpjegojë rëndësinë e pastërtisë. Përderisa disa njerëz zbatojnë pastërtinë vetjake, disa të tjerë fatkeqësisht as që brengosen. Si rrjedhojë shprehia dhe natyra e njeriut rreth pastërtisë duhet të bëhet pjesë e përditshmërisë sonë.

Nevoja për t’u pastruar dhe bërë gati për namaz mbart kuptim dhe domethënie shpirtërore; duhet të pastrohemi nga të gjitha papastërtitë e anës së jashtme të njeriut si dhe t’i kushtojmë rëndësi të veçantë pastrimit të zemrës nga veset e këqija, në mënyrë që të jemi në gjendje të komunikojmë me Krijuesin e kësaj gjithësie.

XVII

RREGULLAT USHQIMORE

Ajo që më ka joshur nga Kur’ani qysh nga ditët e para, është se saherë që Allahu urdhëron me ndonjë nga urdhëresat e Tij, gjithmonë na shpjegon edhe arsyet e ajetit. Vërtetë që jemi qenie njerëzore inteligjente. Pothuajse secili nga ne e di se mishi i derrit është i ndaluar, mirëpo përveç këtij lloji të ushqimit, hasim edhe në shumë ushqime të tjera të ndaluara:

Allahu xh.sh. thotë:

“Dhe mos hani nga ajo, (para therjes së të cilës) nuk është përmendur emri i Allahut, vërtet ajo (ngrënie) është mëkat. Djallët i nxisin miqtë e tyre që t’ju polemizojnë, e nëse i dëgjoni, bëheni si ata (idhujtarë)”. [Kur’an 6:121].

Po ashtu edhe në ajetin vijues i Plotfuqishmi thotë:

“Thuaj: ‘Në atë që më është shpallur (në Kur’an) nuk po gjej të ndaluar diçka nga ushqimi, përveç në qoftë se (ushqimi) është: cofëtinë, gjak i derdhur ose mish derri - ai është i ndytë, dhe pos asaj që është therrur jo në emër të Allahut (por të ndonjë idhulli) e që është mëkat. E kush detyrohet (t’i hajë këto), por duke mos pasur për qëllim shijen dhe duke mos e tepruar, Zoti yt është që falë e mëshiron shumë”. [Kur’an 6:145].

Nga ky ajet dhe ajete të tjera, shohim se Allahu xh.sh. na e ka ndaluar të ushqyerit me këto lloje ushqimesh: *cofëtinën, çdo gjë që vdes vetiu, gjakun e derdhur, mishin e derrit, për arsye se konsiderohet neveri dhe e papëlqyer, po ashtu mishi i therur për hir të idhujve si dhe mishi i kafshës së therur pa u përmendur emri i Allahut të Madhërisëm.* Mirëpo, sërish në fund të ajetit shohim se Allahu sikur na e bën me dije që nëse hamë diçka nga ushqimet e lartpërmendura pa pasur njohuri mbi dispozitat dhe duke mos pasur për qëllim shijen, pa dyshim se Allahu do të na e falë, si rrjedhojë mund të themi se

qëllimi i ajetit përsëri është bërë i qartë dhe i ditur për mbarë njerëzimin. Nga ushqimet që cekëm më lart, kurrësi nuk duhet ngrënë asgjë, ngase nuk janë të dobishme për shëndetin, së këndejmi jemi të porositur që t'i bindemi urdhërit të Krijuesit, e gjithë kjo është në favor të shpirtit tanë! Në vazhdim, Allahu i Plotfuqishëm, kur flet mbi çështjen e tepimit dhe shpërdorimit të ushqimit, na e tërheq vërejtjen duke thënë:

“S’ka dyshim se kanë dështuar keq ata që mbytën fëmijët e tyre nga mendjelehtësia e pa kurrfarë dije, dhe ata që duke i shpifur Zotit, shpallën të ndaluar atë që Zoti u kishte dhuruar. Ata kanë humbur rrugën e drejtë dhe prej fillimit nuk ishin në udhëzim. Ai është që krijoi kopshte (bimët e të cilave) të ngritura lart (në shtylla) dhe të rrafshata (të shtrira në tokë), edhe hurmet dhe drithërat me frute (shije) të ndryshme; (krijoi) ullinjë dhe shegët e ngjashme (nga forma) e jo të ngjashme (nga shija). Hani frutat e tyre kur të piqen dhe ditën e vjeljes së frutave jepeni atë pjesë që është obligim (të varfërve e nevojtarëve) dhe mos teproni, pse Ai nuk i do shkapërderdhësit”. [Kur’an 6:140-141].

Si shkak i kryerjes së shumë mëkateve e krimeve është edhe mosnjohja e të mirës dhe të keqes, të drejtës dhe të padrejtës, kur njerëzit nuk janë në gjendje të dallojnë midis këtyre dy çështjeve, pa dyshim se ata janë në gjendje të kryejnë të gjitha llojet e mëkateve, të përfshihen edhe në kryerjen e krimeve, madje mund edhe t'i vrasin

fëmijët e tyre; të ndalojnë edhe atë që Allahu e ka bërë të lejuar për ne. Është shumë pikëlluese kur hasim në këtë kategori njerëzish. Vetëm Allahu është Ai që dhuron të gjitha llojet e ushqimeve për krijesat e Tij. Këtë mund ta vërtetojmë nga ajeti i sapopërmendur; njëherazi jemi të porositur që një pjesë t’ua dhurojmë të varfërve e nevojtarëve. Mirëpo, mos të harrojmë se shpërdorimi i ushqimit është i ndaluar, pasi ka shumë njerëz të varfër dhe po qe se nuk mendojmë rreth hallit të tyre, do të tregohemi shumë egoistë. Mësimi i fundit që mund të nxjerrim nga ky ajet është edhe ky: Allahu xh.sh. nuk i do ata që e teprojnë dhe që ushqimin e tyre e shpërdorin, duke vepruar në kundërshtim me ligjin dhe normat islame. Do të ishte mirë sikur këtë mësim ta kujtonim përherë.

XVIII NAMAZI

Njeriu gjatë namazit komunikon me Krijuesin, mirëpo nëse pyesni se si ta përkufizoj nocionin ‘namaz’ apo ‘të falurit’, do të kisha thënë se namazi është ushqim për shpirtin. Kur posedojmë një ushqim të mirë, një shujtë të

harmonizuar, padyshim se ndihemi të ngopur e të qetësuar, përderisa gjatë faljes ndihemi të lumtur e të kënaqur. Prandaj prej nesh kërkohet që shpirtin ta ushqejmë pesë herë në ditë. Namazin tonë e fillojmë me lutjen, duanë dhe suren më të bukur ndër të gjitha e ajo është kaptina hyrëse, më saktësisht e njohur nga të gjithë ne me emrin Sure el-Fatiha:

“Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit! Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve! Mëshiruesit, Mëshirëbërësit! Sunduesit të Ditës së Gjykimit! Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm tek Ti kërkojmë ndihmë! Udhëzona në rrugën e drejtë! Në rrugën e atyre, që i begatove me të mira, jo në të atyre që kundër veti tërhoqën hidhërimin, e as në të atyre që e humbën veten!” [Kur’an 1:1-7].

Sikur ta rroknim kuptimin e thellë të kësaj kaptine kur’anore dhe ta zbatonim në jetën tonë, nuk do të kishim pasur nevojë për diç më shumë. Gjithashtu, para lindjes së diellit jemi të porositur që doemos ta kryejmë faljen e mëngjesit. Është pak e rëndë të zgjohemi nga gjumi në



këtë kohë, mirëpo prapë jemi të obliguar që këtë obligim ta kryejmë.

Sido që të jetë, në çastin kur braktisim të dashurin tonë gjumë që të falemi, atëherë veç e kemi kuptuar rëndësinë e namazit. Gjatë kësaj kohe, mendjet tona janë të pastërta dhe të kthjellta nga të gjitha gjërat materiale të kësaj bote dhe për këtë namazi do të dëshmojë. Duhet cekur se gjatë kryerjes së namazit të mëngjesit, kemi një lutje shumë të veçantë, të cilën duhet ta shqiptojmë patjetër gjatë namazit:

“Ata të cilët thonë: ‘Zoti ynë, ne sinqerisht besuam, na i fal mëkatet tona e na ruaj prej n d ë s h k i m i t t ë zjarrit!’” [Kur’an 3:16].

Më pas vazhdojmë me namazin e mesditës, pastaj me namazin e pasdites, namazin e muzgut dhe më vonë me namazin e mbrëmjes. Duhet ta kemi parasysh se gjatë kryerjes së këtyre namazeve, duhet treguar sinqeritet. Sikur të ishim në gjendje të jemi të sinqertë si fëmijët, do të ishim kthyer te Zoti në të njëjtën gjendje në të cilën na lindi nëna: të pastër dhe të sinqertë, pa asnjë mëkat.

“Thuaj: ‘Allahu më urdhëroi drejtësinë dhe në tërësi kthejuni Atij në çdo namaz dhe adhurojeni duke qenë të sinqertë në lutje vetëm për Të. Ashtu sikur që ju filloi së pari do të ktheheni te Ai’”. [Kur’an 7:29].

Vërtet, kemi perceptim të gabuar mbi termin sukses, të cilin shumica e njerëzve e lidhin me paratë, karrierën apo familjen e madhe. Sidoqoftë, sukcesi i vërtetë është të jesh besimtar i drejtë, i vazhdueshëm në kryerjen e namazeve dhe

nënkupton nënshtrimin e përlësinë, ngase vetëm besimtarët do të hynë në parajsë:

“Është e sigurt se kanë shpëtuar besimtarët: Ata të cilët janë të përlur dhe të kujdesshëm gjatë faljes së namazit”. [Kur’an 23:1-2].



“Thuaj: ‘Namazi im, kurbanimi im, jeta ime dhe vdekja ime janë thjesht për Allahun, Zotin e botëve. Ai nuk ka shok. Me këtë jam i urdhëruar dhe jam i pari i muslimanëve!’”

Po ashtu edhe në ajetet vijuese, Allahu xh.sh. thotë:

“Dhe ata të cilët i kushtojnë kujdes kohës së namazit të tyre. Të tillët janë mu ata trashëgimtarët, të cilët e trashëgojnë Firdevsin dhe aty ata janë përgjithmonë”. [Kur’an 23:9-11].

Në Kur’anin famëlartë ka mjaft sure të bukura, ne mund të zgjedhim atë që e dëshirojmë më së shumti për nevojat tona, për vlerat tona dhe për moshën. Lutjen të cilën më së shumti e parapëlqej gjatë jetës sime është: **“Thuaj: ‘Namazi im, kurbanimi im, jeta ime dhe vdekja ime janë thjesht për Allahun, Zotin e botëve. Ai nuk ka shok. Me këtë jam i urdhëruar dhe jam i pari i muslimanëve!’”** [Kur’an 6:162-163].

Përmendja e Allahut xh.sh.

gjatë kryerjes së namazit sjell një ndjenjë dhe emocion të paqes dhe qetësisë, e cila pastaj e mbështjell edhe zemrën. Ja se ç’thotë Allahu në vazhdim:

“Ti lexo atë që po të shpallet nga libri (Kur’ani), fal namazin, vërtet namazi largon nga të shëmtuarat dhe

të irituarat, e përmendja e Allahut është më e madhja (e adhurimeve); Allahu e di se ç’punoni.” [Kur’an 29:45].

Gjatë ditës kemi aktivitete të ndryshme në kohë të ndryshme dhe, ndër to doemos duhet patur në konsideratë praninë e të Madhit Allah. Duke përmendur Allahun vazhdimisht, zgjedhjet tona drejt rrugës së drejtë do të përfundojnë dhe përmbushen më me lehtësi. Kur jemi në gjendje të keqe, mësohemi se si të kërkojmë ndihmën nga Allahu i Madhërishtëm; kur jemi në pozitë të mirë dhe ndihemi të qetë, mësohemi se si ta falënderojmë Atë.

Vazhdon në numrin e ardhshëm

Nga gjuha angleze:

Feim Dragusha

Marrë nga libri: **Qur’an in Our Everyday Life.**

PËRKTTHIME

NUK JE TI I VERBËR, POR UNË ISHA I VERBËR!

Muhamed el-Arifi

Nuk i kisha kaluar të tridhjetat kur gruaja ime lindi fëmijën tonë të parë. Akoma vazhdoj dhe kujtoj atë natë me shokët e mi, në një prej vendeve të pushimit ku kalonim natën, të mbushura me fjalë dhe biseda të kota, madje edhe me përgojime dhe harame të tjera. Isha unë ai që e mbaja fjalën më së shumti në mesin e shokëve duke përgojuar dhe u tallur me njerëz, kurse shokët e mi qeshnin dhe kënaqeshin me këtë. Këtë natë kam qeshur shumë. Posedoja talent të çuditshëm në imitim e njerëzve, sa që edhe zërin e ndryshoja sikur zëri i personit që e imitoja. Tallesha me secilin, sa që edhe shokët e mi nuk i kurseja nga kjo. Kujtoj këtë natë, ku u talla me një të verbër që lypete në treg. Ia vura këmbën përpara, zuri në këmbën time dhe u rrezua. Më tha diçka por nuk e mora vesh se ç'foli. Shokët dhe të gjithë njerëzit që ishin në treg qeshnin. U ktheva atë natë shumë vonë në shtëpi si gjithëherë dhe gjeta gruan time duke më pritur. I vinte keq për gjendjen time, me pyeti me zë të ulët dhe të dobësuar: Rashid, ku ishe? Ia ktheva me shaka: Në Mars, tek shokët si zakonisht. Ishte tepër e lodhur. Mori të flasë por lotët e kishin ngulfatur: Rashid, jam lodhur shumë, dhe me duket qartë se më është afruar koha e lindjes. Ndjeva në vetën time se kam qenë i

pakujdesur për të. Ka qenë e duhur të jam më i kujdesur për të dhe me afër saj, dhe të rrijë më pak natën jashtë shtëpisë, veçanërisht në muajin e saj të lindjes.

E dërgova në spital me shpejtësi, hyri në dhomën e lindjes dhe filloi t'i ndjejë dhimbjet e lindjes. Me orë të tëra prita lindjen, derisa më humbi durimi duke pritur dhe thash të shkojë në shtëpi, dhe lashë



numrin e telefonit tek përgjegjësit, që të më thërrasin kur të lindë. U ktheva në shtëpi të pushojë. Pas një ore më lajmëruan për të më përgëzuar për lindjen e djalit, Salimit. Shkova në spital menjëherë. I pari që më takoi me pyeti për numrin e dhomës dhe informatat tjera për shoqen time. Kërkuan prej meje të paraqitesha së pari të doktoresha, që ishte kujdesur për shoqen time. Bërtita me vrazhdësi: Çfarë doktoreshe! Me rëndësi është ta shohë djalin tim. Por me detyruan që të shkoj tek doktoresha. Hyra tek ajo dhe me lajmëroi se lindja e djalit tuaj

është me të meta. Më këshilloi që të pajtohem me caktimin e All-llahut, pastaj më tha se djali juaj ka deformim të madh në të dy sytë e tij dhe kjo konkludon se djali juaj është i verbër.

E ula kokën dhe u mundova t'i ndali lotët dhe menjëherë kujtova lypësin e verbër, të cilin e kisha rrëzuar në treg dhe qeshen njerëzit me të. Thashë: Subhanallah ç'ka të mbjellësh korrë. Qëndrova kështu për një çast dhe nuk dija se çka të thoja. Mu kujtua gruaja dhe djali. Falënderova doktoreshën për butësinë dhe sjelljen e saj dhe shkova ta shoh gruan dhe djalin.

Gruaja nuk ishte e dëshpëruar për atë që na kishte goditur, ishte besimtare e fortë në caktimin e All-llahut dhe e kënaqur me të. Shpesh më këshillonte që të mos tallem me njerëz, dhe e përsëriste shpesh mos i përqesh njerëzit! Dolëm prej spitalit, doli edhe Salimi i vogël me ne. Në të vërtetë, nuk u kujdesesha shumë për Salimin. E konsideroja sikur të mos ishte prezent në shtëpi, sa që kur qante shumë ikja nga dhoma e fjetjes dhe dilja në sallon dhe flija. Ndërsa gruaja ime kujdesej shumë për të dhe e donte shumë.. Kurse unë, jo që e urreja, mirëpo nuk mund ta doja, nuk e di pse...?! Rritej Salimi dhe filloi të zvarritej. Kur mbushi afër gjashtë vjet, mendohej të ecte. Vërejtëm tek ai se ishte edhe i gjymtë në këmbë.

Pas Salimit, që ishte fëmija

ynë i parë, lindi dhe Umeri dhe Halidi.

Kalonin vitet, rritej Salimi dhe rriteshin edhe vëllezërit e tij. Nuk e pëlqejta të rrija në shtëpi, si gjithmonë isha me shokët e mi. Në të vërtetë, isha bërë si lodër në duart e tyre. Nuk shpresonte gruaja ime se unë mund të përmirësohesha. Porse ajo gjithmonë lutej që të më udhëzonte All-llahu dhe nuk hidhërohej prej veprimeve të mijta të pamatura.. Hidhërohej vetëm kur shihte moskujdesjen time ndaj Salimit dhe interesimin tim të madh për vëllezërit e tij. Rritej Salimi, por rritej edhe brengosja ime për të, nuk e refuzova kërkesën e gruas sime që ta regjistrojë Salimin në një shkollë për të nxënësit me të meta. Isha i pakujdesshëm ndaj kohës dhe vitet shkonin, ditët më ishin bërë të njëjta, punëgjumë, ushqim dhe qëndrim në orët e vona të natës, kjo ishte dita dhe jeta ime.

Ishte ditë e xhuma, u zgjova në ora njëmbëdhjetë të drekës, për mua ishte akoma herët. Kisha një takim, në një gosti më kishin ftuar, u veshja bukur, u parfumosa dhe vendosa të dal. Duke kaluar nëpër korridorin e shtëpisë, papritmas ma tërhoqi vërejtjen Salimi duke qarë shumë me një zë të madh. Ishte hera e parë që vërejtja Salimin duke qarë, që prej kur ishte i vogël. Dhjetë vite kishin kaluar e unë nuk i jam afruar atij. U mundova ta injoroj sikurse nuk po e dëgjoj, mirëpo nuk u mbajta, dëgjova zërin e tij duke thirrur nënë e tij kurse unë isha prezent. Ktheva kokën kah ai, pastaj u afrova tek ai dhe i thashë: Salim, pse qanë? Çfarë ke? Sapo dëgjoj

zërin tim u ndal nga të qajturit dhe kur ndjeu se jam afër tij filloi të prekë përreth tij me dy duart e tija të vogla.

E kuptova se po mundohet të largohet nga unë, sikur donë të më thoshte: "Tash gjete kohë të interesohesh për mua, ku ishe që dhjetë vite?!" Hyri në dhomën e tij e unë i shkova nga pas. Në fillim refuzoi të më tregonte shkaku se pse qante. U mundova të sillem butë me të deri sa filloi të më tregoi problemin. Ishte vonuar Umeri, i cili e dërgonte atë në xhami për namaz të xhumasë, ishte frikuar se nuk do të gjente vend në saffin e parë, thirri Umerin dhe thirri nënën e tij, porse nuk i përgjigjej askush dhe qau. I shikoja lotët e tija, që i rridhnin nga sytë e verbër. Subhanallah thashë, unë isha i verbër e jo ai! Nuk e mbajta dot vetën deri në fund të fjalës së tij, vendosa dorën time mbi gojën e tij dhe i thash: Për këtë ke qarë, o Salim? Ma ktheu: Po. I harrova shokët e mi, e harrova gostinë, që kisha për të shkuar, dhe i thash: O Salim, mos u hidhëro! A e din se kush do të dërgojë ty sot në xhami? Tha: Sigurisht Umeri porse ai vonohet gjithmonë. Ia ktheva: Jo Umeri, por unë do të dërgoj sot në xhami. U habit Salimi, nuk e besonte këtë, mendoi se po bëja shaka me të dhe filloi të qajë. Ia fshiva lotët e tija me dorë dhe e kapa për dorë.

Desha ta dërgojë me veturë, porse refuzoi duke me thënë: Xhamia është afër dhe kam dëshirë të eci deri në xhami. Nuk e kujtoja herën e fundit që kam hyrë në xhami, porse ishte hera e parë që ndjeva frikë dhe pendim për ato vite të gjata, që

më kishin shkuar pa falur namaz. Kishte qenë xhamia e mbushur me besimtarë, por, për Salimin gjeta një vend në rreshtin e parë. Dëgjua hutben e xhumasë së bashku dhe u fal Salimi afër meje..

Në fakt unë u fala afër tij. Pasi mbaroi namazi, kërkoi prej meje që t'ia afroi Kuranin. U habita! Si do të lexon kurse ai është i verbër?! Ne fillim e injorova kërkesën e tij, mirëpo u frikova mos po i shkaktoj plagë në vetën e tij dhe ia dhashë Mus'hafin. Kërkoi prej meje që t'ia hapi Mus'hafin tek sureja Kehf. Fillova ta shfletojë Mus'hafin derisa e gjeta në përmbajtje suren Kehf. E mori, e vendosi përpara vetës dhe filloi ta recitojë suren me sy të mbyllur. O All-llah! - thash i çuditur. Ai e ka mësuar tërë suren Kehf. U turpërova prej vetës, e kapa një Mus'haf që të lexoj, ndjeva një dridhje në vete nga frika. Lexova e lexova dhe e luta All-llahun të më falë dhe të më udhëzojë. Fillova të qajë i penduar me një zë sikur fëmijë. Disa njerëz akoma ishin të pranishëm në xhami duke falur nafile, u turpërova prej tyre dhe u mundova të mos e marrin vesh që po qajë. Pas pak ndjeva dorën e vogël të Salimit duke prekur fytyrën time, duke m'i fshirë lotët, që më kishin mbuluar. E afrova dhe e shtrëngova për gjoksi duke e përqaftuar, e shikova njëherë dhe tash në vete: Ti nuk je i verbër, por unë jam i verbër.

U kthyes në shtëpi. Gruaja ime ishte brengosur shumë për Salimin. Mirëpo, kur mori vesh se unë kam qenë me të në xhami dhe kam falur namazin me të,

brenga e saj u kthye në gëzim. Nga kjo ditë nuk kam lënë namaz pa falur në xhami. Braktisa shoqërinë e shfrenuar të natës dhe bëra shoqëri më të mirë, shokë të xhamisë, të cilët i njoftova në xhami dhe shijova ëmbëlsinë e imanit me ta.

Mësova shumë gjëra prej tyre, që dynjaja m'i kishte harruar. Nuk leja ligjëratë, që mbahej në xhami e që nuk prezantoja në to, e bëra hatme edhe Kur'anin disa herë në muaj, u lidh gjuha ime me përmendjen e All-llahut në çdo kohë, me shpresë që të më falë All-llahu për përgojimet dhe gjynahet tjera që i kisha bërë. U afrova më afër familjes si kurrë më parë. Një ditë, vendosen shokët e mi të mirë të shkojnë në një vend larg nga shtëpia ime, për të bërë thirrje në Islam. Në fillim, nuk isha i vendosur të shkojë me ta, por pasi fala namaz istihare dhe lajmërova bashkëshorten time, që mendova se do të refuzonte, por përkundrazi u pajtua me vendimin tim dhe me nxitin në këtë qëllim. Ishte hera e parë që e lajmëroja gruan time për shkuarje në një vend jo të shfrenuar dhe të urrejtur e të mbushur me harame. U drejtova kah Salimi, i tregova për udhëtimin tim, me kapi me dy krahët e tij të vegjël dhe më përqafoj duke u lutur për mua. Mungova në familje afërsisht tre muaj e gjysmë. Gjatë kësaj kohe thirrja në telefon sa herë që më jepej mundësia, bisedoja me bashkëshorten dhe fëmijët. Filloi të më kapë një mall i madh.

Ah... sa më mori malli për Salimin. Kisha dëshirë ta dëgjoja zërin e Salimit, ai ishte i vetmi që nuk kisha biseduar me të prej që

kisha udhëtuar. Nuk e dija shkaku, ose është në shkollë mendoja ose në xhami në kohën kur thirrja. Sa herë që bisedoja me bashkëshorten, i tregoja për mallin që më kishte marrë për Salimin, kurse ajo qeshte e gëzuar dhe duke më përgëzuar për të.

Vetëm se në herën e fundit kur bisedova, nuk e dëgjoja të qeshurën e saj, si zakonisht, për habi kishte ndërruar zërin e saj. I thash t'i dërgonte selam Salimit nga unë. Ma ktheu: Inshallah, dhe pushoi. Pasi që erdhi koha e kthimit në shtëpi u gëzova shumë. Kur u ofrova derës së shtëpisë trokita dhe shpresoja që ta hapë derën Salimi. Papritmas, e hapi derën Halid, i cili akoma nuk i kishte mbushur katër vite. E përqafova dhe e barta me krahët e mi, kurse ai bërtiste: Babi... babi...! Nuk e di, sa hyra në shtëpi ndjeva një ngushtim në vetën time, kërkova ndihmë nga All-llahu prej shejtanit të mallkuar.

Ndeja me gruan time, pashë se ishte e vrenjtur në fytyrë, nuk ishte sikur herëve të tjerave. U mundua të paraqitej si e gëzuar për ardhjen time. E pyeta se çka ndodhur?

M'u përgjigj:

Asgjë! Në çast m'u kujtua Salimi. I thashë: Ku është Salimi? Uli kokën e saj dhe nuk m'u përgjigj,

ndërsa në fytyrën e saj filluan t'i rrjedhin lotët. Bërtita prapë: Ku është Salimi? Nuk foli askush. Më pas m'u afrova Halidi i vogël duke belbëzuar dhe tha: Baba, Salimi ka shkuar në xhenet tek All-llahu. Gruaja filloi të qajë me të madhe gati sa nuk u përplas për tokë dhe doli nga dhoma e pikëlluar për ndarjen e Salimit. Pas kësaj, mora vesh se dy javë para se të mbërrija Salimin e kishte goditur një temperaturë e madhe dhe ethe dhe bashkëshortja e kishte dërguar në spital. Mirëpo, sëmundja i ishte rënduar u nda nga kjo botë. Salimi nuk ishte i verbër por unë isha i verbër. O All-llah, sa kënaqësi është ta shijosh ëmbëlsinë e imanit! All-llahu e mëshiroftë Salimin! E njohu All-llahun edhe pse ishte i verbër. Sa e sa njerëz sot posedojnë shqisa të shëndosha por nuk shohin dhe nuk e njohin All-llahun [subhanehu ve teal].



Përktheu: **Fatmir Zogaj**
Burimi: www.ankebut.com

PËRKTTHIME

I KTHYERI NGA GUANTANAMO

Adil Abdullah

Vijon nga numri i kaluar

«Kërkimi ndaj arabëve»

Nën hijen e këtyre rrëmujave të dhunshme, vendimi për tu larguar në veri, jug, lindje apo perëndim nuk ishte lehtë, ndodh që të shpie rruga në siguri, por mund të ndodh që të shpie edhe në duart e forcave që kërkonin për arabet për t'i mbytur ata apo për t'ia dorëzuar amerikanëve në këmbim të shpërblimeve financiare, të cilat ishin të caktuara për çdokënd që sillte me vete një arab të gjallë apo të vdekur.

Gjendja e arabeve ishte në mes të mangave të këmishës; amerikanët dëshironin të hakmerreshin në shenjë të sulmeve të 11 shtatorit, përderisa armatat e veriut gjurmonin për arabët që të hakmerren për vrasjen e komandantit të tyre Ahmed Shah Mes'ud, dhe në anën tjetër të fitonin shpërblime dhe ndihma financiare.

Edhe pse unë nuk kisha lidhje fare me sulmet e shtatorit, as me vrasjen e Mes'udit, mirëpo nacionaliteti im arab mjaftonte për rrezikun tim që më kanosej, andaj, situata kërkonte daljen e shpejtë nga ky qorrrokak (rrugë pa krye), por, si ta kuptojnë amerikanët dhe veriorët se unë jam i pastër nga të dyja akuzat (sulmeve të 11 shtatorit dhe vrasjes së Mes'dit).

Pata fat që gjatë kësaj kohe të takohem me vëllain Omer

Rexheb el-kuvejtij dhe Abdulhadi es-Sebiij es-suudij, vendosëm që të lëvizim gjithë së bashku, filluam të bartemi me ngadalësi dhe kujdes të madh nga qyteti në qytet dhe nga fshati në fshat duke shpresuar se mund të arrijmë në kufirin pakistanez.

«Ndhimesa përmes një udhëzuesi afgan»

Bombardimet amerikane arritën kulminacionin, aeroplanët bombardues bombardonin çdo gjë që rastiste pa ndonjë dallim, mijëra burra, gra, fëmijë dhe pleq u sakrifikuam.

Nga reporteri i Al-xhezires, Sami el-Haxh kur u takuam në burgun Guantanamo dëgjova se disa fshatra janë fshirë edhe nga harta (nga bombardimet). Stacioni televizor 'Al-Xhazira' kishte fotografuar disa nga këto gjenocide dhe kishte raportuar gjerësisht për këto, andaj, forcat amerikane e dënuan kanalën e Xhezires me marrjen e reporterit Sami el-Haxh në burgun Guantanamo, edhe pse ai vetëm raportonte për ngjarjet fjalë për fjalë.

Me dy vëllezërit, Omerin dhe Abdulhadin arritëm në njërin nga fshatrat afgan, posa e kuptuan ata për ardhjen e mysafirëve arab, na pritën në pritjen më të mirë, na nderuan e na morën në shtëpitë e tyre. Të nesërmen ne i lajmëruam ata se ne jemi në rrezik nëse biem në duart e kundërshtarëve, por ata na qetësuan dhe na premtuan se do të na ndihmojnë deri sa të

arrijmë në Pakistan.

Dhe me të vërtetë ata caktuan dy burra të fshatit që të na shoqërojnë gjatë udhëtimit për t'u larguar, ngase udhëtimi përmes veturave ishte jo i sigurt, sepse gjatë rrugës gjendeshin punkte të shumta ushtarake, kështu që me sigurti për ne ishte të ecim përmes fshatrave derisa të arrijmë në Pakistan.

Fshatarët siguruan për ne rroba afgane, na siguruan ushqim, pije, si dhe rroba të vjeshtës, ata e kryen një obligim ndaj nesh në formën më të mirë, Zoti i shpërbleftë të gjithë me të mira.

Dy udhëzuesit që ishin me ne, njihnin fshatrat që kalonim në to, dhe largoheshin nga fshatrat që nuk ishin të sigurt dhe që mund të na mashtronin banorët e tyre.

Në fshatrat që kalonim, banorët e tyre na nderonin dhe përgatitnin ushqim, pije dhe strehim për ne, dy udhëzuesit e rrugës vazhduan të qëndronin me ne derisa ne iu afruam kufirit pakistanez. Pas kësaj, një afgan na paraqiti një shumë të hollash që ne duhet të paguanim për të na drejtuar ai tek ambasadat e vendeve tona. Dy udhëzuesit tanë dëshiruan ta paguanin shumë, por ne ndërhyëm, falënderuam ata dhe i lajmëruam se ne do t'i paguajmë atij kur të arrijmë të sigurt në ambasadat tona. Kështu që vazhduam udhëtimin me udhëzuesi e ri përgjatë zonave kufitare derisa u futëm në tokat pakistaneze.

Gjatë këtij udhëtimit derisa dolëm nga Afganistani, ne

kaluam shumë zona pyjore, malore, kodra dhe lumenj. Koha ishte shumë e ftohtë, mbi ne binte shi dhe dëborë. Në fazën e fundit nga udhëtimi ynë, u detyruam të kalojmë përmes kodrave të larta, të cilat arrinin lartësinë e tyre deri në katër mijë

Ditët që nuk i agjëruam gjatë udhëtimit tonë nga Afganistani, i përfunduam duke agjëruar në burgun e Guantanamo.

Nëpër fshatrat që kalonim, njerëzit na shprehnin mirëseardhje, na ndihmonin dhe na nderonin me gjithë varfërinë

Talibanët, atëherë u ngritën amerikanët duke bombarduar dhe shkatërruar ato fshatra, derisa zhduken nga dheu i tyre. Kjo është natyra e ushtrisë amerikane. Ata nga largësia e tyre nuk ballafaqoheshin me armiq të tyre ballë për ballë, mirëpo, bombardonin fshatrat nga distanca dhe mbytnin gratë, fëmijët dhe pleqtë.

«Fshehja nga sytë e mercenarëve
-njerëzve të paguar»



metra përafërsisht.

Ecim nëpër borë që nganjëherë arrinte deri në gjurin tonë, ndonjëherë tjetër deri te kofsha, e nganjëherë edhe më shumë.

Udhëtimi ishte shumë i vështirë dhe tepër i mundimshëm, saqë edhe udhëzuesi detyrohej të kërkonte ndihmë përmes udhëzuesve tjerë, në mënyrë që t'iu shmanget rënies në gropa dhe rajone që ishin mbuluar me borë, që po të binim në to do ishim sigurt të vdekur.

Ecja jonë ishte gjithmonë ditën, ngase ecja gjatë natës ishte tepër e rrezikshme për shkaqet që i kam cekur më lartë. Ishte muaji i ramazanit që kishte hyrë përderisa ne po udhëtonim, disa ditë i agjëruam, e disa tjera u detyruam ta braktisim agjërimin nga lodhja e tepërt dhe uria.

dhe nevojën e tyre. Paritë e fshatit dhe të vjetrit qëndronin dhe dilnin me ne, u shprehnin mirëseardhje arabëve për ndihmën e tyre ndaj popullit Afgan. Na kërkonin falje se nuk po mundën të na ndihmojnë në formën më të mirë dhe të plotë, dhe se nuk mund të qëndronin së bashku me ne në sprovat dhe vështirësitë, dhe e tera kjo ishte për shkak të kaosit që mbretëronte në vend dhe hyrjes së të huajve në të. Fshatrat që iu ndihmonin arabëve apo i strehonin ata, përballeshin me bombardim dhe shkatërrim, disa fshatra u zhduken nga harta e tyre vetëm për shkak se ndihmonin dhe strehonin arabët. Dhe e tëra kjo ndodhi pasi spiunët/lajmëtarët nga shpirtat e dobët raportonin për këto fshatra dhe akuzonin banorët e tyre se po bashkëpunojnë me

E kundërta nga ato skena të shkëlqyeshme të dashurisë afgane ndaj arabëve dhe përgatitjes së tyre në ndihmë apo çdo shërbimi që kërkonim ne, bile thoshin se ne do të sakrifikojmë edhe shpirtat tanë dhe të fëmijëve tanë, ngase ne për ta ishin si fëmijët e sahabëve -shokëve të Profetit, që kishim ardhur nga vendet arabe për t'i ndihmuar dhe shpëtuar ata, ishin disa afgan dhe pakistanez të cilët shëtisnin në kërkim të arabëve, lakmitar ndaj shpërblimeve financiare që dhuronin amerikanët për atë që dorëzonin ndonjë arab. Me gjithë nevojën tonë të madhe për ushqim dhe pushim, ishte e natyrshme që të fshihemi nga vështrimet e njerëzve.

Në vend se të kërkonim ndihmë nga kalimtarët, ne fshiheshim prej tyre nga frika se ndoshta ata janë të paguar në kërkimin tonë. Në kohën kur disa afgan kërkonin me ngulm për arabet, në mënyrë që t'ua dorëzonin amerikanëve, në anën tjetër shumica e afganëve i donin arabët, mburreshin me ta, dhe i vendosnin kryevendi nëse ishin mysafirë, kur një arab fliste afgani e dëgjonte atë me vëmendje dhe fjalët e tij i mernte

me sinqeritet dhe vërtetësi.

Erdhi Fitër Bajrami, por s'kishte shije bajrami tek Afganët, edhe pse njerëzit mundoheshin të ndiheshin të gëzuar dhe të lumtur me ardhjen e bajramit. Rënia e viktimave të shumta nga djemtë e tyre, bile rënia e tërë Afganistanit në duart e forcave amerikane, e shujtën gëzimin e vërtetë nga zemrat dhe fytyrat e tyre.

«Në duart e forcave pakistaneze»

Pas një udhëtimi të gjatë, vërejtëm nga largësia pikën kufitare të ushtrisë pakistaneze, para neve ishin dy zgjedhje; ose të shkonim tek ushtarët pakistanez e t'iu rrëfenim atyre

udhëtimin tonë për në tokat pakistaneze. Letrat dhe dokumentet tona ishin në mënyrë të rregullt dhe se hyrja jonë në Afganistan ishte bërë në mënyrë legale dhe ligjore. Lodhja jonë ishte në nivelin më të lartë, dhe nuk kishim forcë për ta vazhduar edhe më tej udhëtimin në vendet e panjohura, ngase spiunët afgan, amerikanët, uria, etja dhe lodhja ishin armiqtë tanë që na ndjekin neve. Kështu që vendosëm të shkonim tek ajo pika kufitare ku qëndronin ushtarët pakistanez dhe të kërkonim prej tyre të na drejtonin tek ambasadat e vendeve tona që ndodheshin në Pakistan. Së paku u çlodhëm nga ky vendim e që para neve në ato

dhe na informuan se mund të pushoni lirshëm, të shëtitni dhe t'iu përdorni tualetet, na qetësuan se punët do të ecin si është më së miri, dhe se ata do të na marrin neve në mëngjes për të na dërguar në polici në mënyrë që të kryhet procedura e intervistimit në mënyrë sipërfaqësore për t'u ditur identiteti ynë e që pastaj ata do të na dorëzojnë në ambasadat e vendeve tona. Në këtë pikë kufitare ishte një oficer pakistanez që fliste anglisht, ai na qetësonte dhe na thoshte se çështja do të përfundojë mirë, ai kërkoi nga ne që të dorëzojmë gjithë atë që kishim me vete; amanete, gjëra personale, e që ushtria pakistaneze do t'ia dorëzojë më pas ato gjëra ambasadave të vendeve tona. I dhashë atij gjithë atë që posedoja; pasaportën, kartën e identitetit, patentë shoferin, gjithashtu me mua ishte edhe një pjesë e veçantë e pasurisë që ai numëronte atë dhe regjistronte çdo gjë në një letër, më pas ai nënshkroi në atë letër, të cilën gjë e kërkoi edhe nga unë, e pas kësaj të gjitha ato amanete i vendosi në një qese të plastikut....

Ne numrin e ardhshëm mund të lexoni:

Si u tradhtuan nga forcat pakistaneze? Si u takuan me amerikanët? Si u ndeshen ballë-për-ballë me Shërbimet Sekretet të Amerikës? Çfarë u morën në pyetje nga Shërbimet sekrete të Amerikës?! Si dhe shumë e shumë tjera

Tema vazhdon në numrin e ardhshëm të revistës.



se ne jemi arab që dëshirojmë të futemi në Pakistan e nga aty tek ambasadat e vendeve tona, ose të fshihemi nga vështrimet e ushtarëve dhe ta vazhdojmë

momente nuk kishte ndonjë vendim më të mirë se ai.

Ushhtarët pakistanez na pritën shumë mirë, na ofruan ujë, bukë,

PËRKTTHIME

E KAM DITUR QË DO TË VISH

Njëra ndër ditët më të përgjakura të luftës; një ushtar aty pranë e sheh shokun e tij më të afërm duke u rrezuar në tokë. Ishin në një gjendje shumë të vështirë, saqë ne nuk guxonim të lëviznin për asnjë çast nga vendi ku mbroheshin. Ushtari vrapon shpejt dhe shkon tek komandanti, duke iu drejtuar komandantit: **“Komandant, a mund të shkoj shpejt ta marr shokun tim?”** Komandanti po e shikon ushtarin e vet sikur dëshiron t’i thoshte se mos është çmendur. **“A ja vlen të shkosh? Shokut tani është i vrarë, i plagosur në të gjitha anët e trupit, qind për qind ai ka vdekur tani, të lutem mos gabo ngase rrezikon edhe jetën tende”**- ishte përgjigja e komandantit. Mirëpo, këmbëngulësia e ushtarit në kërkesën e tij e detyroi komandantin t’i përgjigjet: **“Në rregull, shko pra”**.

Ishte e pabesueshme se në ato qaste tepër kritike dhe shumë të vështira të mund të shpëtonte ushtari nga plumbat që vinin nga të gjitha anët derisa arriti te shoku i tij. Kur arriti tek ai, e mori atë në krah dhe duke vrapuar me të u rrokullisen për në vendin ku mbroheshin ushtarët-shokët e tij.

.....

Komandanti e kontrolloi ushtarin e tij i cili ishte i përgjakur, pasi e kontrolloi atë

mirë e vërejti se ai kishte ndërruar jetë, andaj iu drejtua ushtarit që vrapoi për ta shpëtuar atë: **“Të tregova që nuk ia vlen, të tregova se nuk vlen ta rrezikosh jetën tënde pasi që ky veç paska vdekur.”**

“Ja vlejti, zotëri komandant” - u përgjigj ushtari, ndërsa pasoi ndërhyrja e shpejtë e komandantit: **“Si ia vlejti kur ky njeri paska vdekur, a nuk e sheh ti?”**



“Komandant, më beso se ia vlejti, unë kur shkova atje ai ende ishte gjallë, fjalët e tij të fundit që unë i dëgjova nga ai ishin më të shtrenjta se çdo gjë tjetër në këtë botë” - këtu nuk mund ta mban vetveten dhe ia plas vajit -, duke qajtur ai përmend fjalët e fundit nga jeta e shokut të tij: **“Ahmet, e kam ditur se do të vish!”** Këto qenë fjalët e shokut të tij: **E kam ditur se do të vish!**

.....

Ndokush që juve ju njeh mirë si vetveten; që mendon për ju mirë dhe është mësuar ashtu, që është i qetë, një njeri që nuk mund të rrini pa të, që di të tregon për ju, të flet për ju është më e dashur për të se çdo gjë tjetër, është i gatshëm të sakrifikon çdo gjë për ju, ndoshta ndonjëherë ankoheni se përse flet shumë, por jeni të sigurt në atë që e thotë, person që aq sa e njeh vetveten ju njeh edhe juve, gjërat që shpeshherë nuk mund t’i flitni me askënd, por ndaj tij nuk nguroni dhe ia rrëfeni të gjitha atij, ai është që ju ndieni ndonjëherë nevojë të madhe për këshillat dhe mendimet e tij. Në ora 3 të mëngjesit duke mos hezituar se ‘mos ndoshta është turp’ atë mund ta thërrisni, e duke mos shikuar fare se a qenka ora 3, 4 apo 5 ai ju thotë atë që duhet ju ta dëgjoni. Në atë errësi të mbrëmjes ai ndez një dritë për ju, një person që ndonjëherë bëhet hije e

juaj, e ndonjëherë ndërgjegjja juaj...eh...dhe nganjëherë person që të vranë ndërgjegjja juaj, dije se ai është një njeri që ju e keni lënë pa gjumë...

A keni ndonjë person të tillë në jetën e juaj? Në qoftë se keni të tillë, atëherë dijani vlerën atij. Le të jetë kjo këshillë për ju, se vështirë është të gjesh mik të mirë...

Përktheu nga gjuha turke:
Ajsel Polaku

LAJME SHKURT

Wilders e quan Kur'anin libër fashist

Geert Wilders, lider i Partisë Liberale në Holandë dhe anëtar në parlamentin e Holandës ofendon Kur'anin dhe mbarë muslimanët me deklaratat e tij fyese.

Gazeta prestigjioze britanike 'Guardian' ka raportuar se lideri i Partisë Liberale në Holandë për momentin është duke përgatitur një film i cili do të flet për fashizmin kur'anor, apo thënë ndryshe, esenca e atij filmit ka të bëjë me tekstet kur'anore që sipas z. Wilders janë tekste fashiste dhe përshkruajnë natyrën jo të tolerueshme të librit të shenjtë të muslimanëve, citon Guardian.

Geert Wilders njihet si ofendues i madh ndaj islamit, muslimanëve dhe vlerave të shenjta të Islamit, ai edhe kohë me parë kishte ofenduar rëndë islamin, andaj qe disa vite ai jeton nën përkujdesjen e plotë të policisë.



Burimi: Aljazeera

Mbi një milionë irakianë janë vrarë që prej pushtimit të këtij vendi

Sipas të dhënave të një instituti anglez, që prej fillimit të luftës në Irak janë vrarë mbi 1 milion e dyqind mijë irakianë.

Sipas këtij burimi më shumë se gjysma e familjeve në Bagdad kanë humbur të paktën një anëtar të tyre. 9 % e viktimave irakiane janë vrarë në sulmet ajrore të forcave amerikane dhe 20 % e tyre janë vrarë në shpërthimet terroriste.

Gjithashtu njoftohet se një rol të madh në vrasjen e civilëve irakianë kanë edhe kompanitë private të sigurimit si Black Water forcat e të cilave janë më të shumta se forcat angleze dhe amerikane në Irak.

Nga ana tjetër mësohet se një marinës amerikan është vrarë në lindje të Bagdadit duke e çuar në 3880 numrin e ushtarëve amerikanë të vrarë deri tani në Irak.

Burimi: www.mesazhi.com



Izraeli nis lirimin e 429 të burgosurve palestinezë

Izraeli ka nisur nga mëngjesi i sotëm lirimin e më shumë se 400 të burgosurve palestinezë në kuadër të përpjekjeve të përbashkëta me presidentin Abas për procesin e paqes në Lindjen e Mesme.

Autobusi i parë me të burgosur u largua nga burgu Ketziot, në jug të Izraelit. "Do të lirojmë 429 të burgosur", tha një zëdhënës i administratës së burgjeve. 20 prej të dënuarve do të kthehen në Gaza, ndërsa të tjerët në Bregun Perëndimor.



Burimi: www.mesazhi.com

PËRVJETOR

GJYKATËSI QE DHA URDHËR PËR VARJEN E SADAM HUSEINIT ZBULON SEKRETET

Në këtë muaj bëhet një vit që kur gjykata irakiane gjykoj ish-presidentin e saj me varje, gjykatësi që e dha këtë urdhër pas një viti flet për atë ndodhi se përse ndodhi si ndodhi dhe shumë gjera tjera që ndërlihdhen me atë.

Gjykatësi Munir Sabri Haddad, është i lindur në vitin 1964 në Kadhimije të Bagdadit, i përket komunitetit Kurd, shkollimin dhe atë Juridik e kishte përfunduar në Universitetin e Bagdadit, kishte punuar pak kohë si gjykatës, e më pas ishte bartur në Amman, kurse pas rrëzimit të pushtetit të Sadam Husejnit në vitin 2003 kthehet në Irak, ku edhe tash jeton aty. Ndiqeni intervistën e tij dhënë gazetës saudite SherK el-Ewsat.

Sherk el-Ewsat: A mund të na përshkruani se si kanë qene takimet e juaja me Sadam Husejnin?
Haddad: Jam takuar disa herë me Sadam Husejnin, hera e parë ka qenë seanca për gjenocidin e tij ndaj kurdëve, e pyeta atë se përse keni vepruar ashtu, përgjigja e tij ishte kjo:

“Kurdët janë pjesë e popullit tim irakian, unë nuk u kam bërë padrejtësi atyre e as të tjerëve...unë i kam luftuar armiqtë e Irakut...”

Sherk el-Ewsat: Pse dhe si u zgjodh dita e parë e bajramit që ai të varet?

Haddad: Zgjedhja e kohës ishte nga Qeveria, në nenet e ligjeve shtetërore thuhet se ‘nuk lejohet kurrsesi varja gjatë ditëve të pushimit dhe festave fetare,’ por një gjykatës amerikan ka lidhur dhe ka komentuar këto nene me nenet tjera, qeveria është ajo e cila ka zgjedh dhe caktuar kohën për varjen e Sadamit, unë vetëm jam pajtuar me atë që erdhi dhe e kam zbatuar.

Sherk el-Ewsat: Çka mund të na thoni për çastet e urdhrit për varjen e tij?

Haddad: U takova me Sadamin, kishte të veshur një pallto të zezë, në dorë kishte një Kur’an të djegur, ai kurrë nuk ishte ndarë nga ai Kur’an, unë e lexoja vendimin me zë të lartë: Gjykata ka gjykuar me varjen tendë...

Sherk el-Ewsat: Pse ishte Kur’ani i djegur?

Haddad: Sipas informacioneve ajo kopje e Kur’anit ishte që nga koha kur aeroplanët amerikanë bombarduan restorantin ku ishte Sadami, ai shpëtoi gjallë, dhe sipas bindjeve të tij shpëtimi i tij ndërlihdhet ngushtë me Kur’anin, dhe atë (Kur’anin) e konsideronte ‘shpëtues’ të jetës së tij. T’i kthehem çasteve të urdhrit për varjen e tij...përderisa unë lexoja vendimin e gjykatës, ai vazhdimisht bërtiste me zë të lartë: “Allahu Ekber-Allahu është më i madh”, pastaj thoshte: “Vdekje për persianet, vdekje për amerikanët...ju jeni armiq të Allahut.” Pastaj policët e morën Sadamin dhe e dërguan në dhomën e varjes, ishte një dhomë e madhe, shumë e ftohtë, aty ndodhi një polemikë në mes Sadamit dhe Rrebiut, ku ai dhe njerëzit e tij e pyetën Sadamin se përse na ke bërë mizori, përse ke ndezur luftërat? Përgjigja e tij ishte: “Unë s’kam luftuar askënd, kam luftuar vetëm armiqtë e Irakut si; persianët dhe amerikanët, e ju ishit të mjerë që as qumësht s’kishit për të pirë, unë ju kam ushqyer dhe ju kam bërë njerëz.” Unë ndërhyra dhe qetësova situatën, aty e pyetëm Sadamin për ndonjë porosi, ai tha këtë Kur’an po ia lë amanet gjykatësit tim Bedr Ivad el-Bender...fjalët e tij porosi për familjen e tij ishin: le të jeton biri im...le të jeton...pastaj u ngjit shkallëve, tek ai nuk vërehej kurrfarë frike, bile as hezitim...

Nuk kishte frikë nga vdekja, kërkuam që t’ia vendosim një qese mbi kokën e tij, por ai refuzoi, kjo ishte një shenjë se ai e sfidoi vdekjen...u ngrit Sadami në vendin e varjes, këtu filluan thirrjet: Rroftë (Mukteda) Sadri, rroftë Sadri (nga fraksioni shia), përgjigja e Sadamit ishte: Ju nuk jeni njerëz, kjo nuk është burrëri...

Sherk el-Ewsat: Si ndiheni kur ju e keni zbatuar urdhrit për varjen e Sadam Husejnit?

Haddad: Ndihem shumë i dëshpëruar për zbatimin e urdhrit ndaj varjes së tij, dhe shpresoj që mos të realizohet më ndonjë gjykim i tillë ndaj askujt në botë, mirëpo ndaj gjithë asaj që ka bërë Sadami ndihem se kam kryer punën time, në gjykatë kam qenë një person që është dashur ta kryej punën e vet, isha gjykatës, gjykata më ngarkoi me zbatimin e urdhrit, e unë e kreu atë, mirëpo sinqerisht nuk dua për askënd varje, unë jam kundër dënimit me varje.

STUDIM

STUDENTËT E TALENTUAR KINEZ BRAKTISIN VENDLINDJEN

Është bërë e ditur se dy e treta e studentëve të talentuar kinez të cilët ndjekin studimet e tyre jashtë vendit, nuk shohin interesim të kthehen në vendlindjen e tyre, raporto i e përditshmja Kineze “China Daily”.

Sipas të dhënave të raportuara nga Akademia e Shkencave Shoqërore në Beijing, thuhet se numri i studiuesve kinez që nuk dëshirojnë kthim në vendlindje zë vendin e parë në Botë. Kina për momentin ka nevojë urgjente për njerëz me ekspertizë, raporto i Li Xiaoli për të përditshmen Kineze. “Është një humbje shumë e madhe për Kinën të shikosh studentët të kualifikuar dhe ekspertë duke braktisur vendin, e veçmas kur dihet fakti i shpenzimeve të mëdha që ky shtet ka investuar për edukimin e tyre” tha ndër të tjera Li Xiaoli.

Sipas një raporti tjetër, është bërë e ditur se që nga viti 2002, më shumë se 100,000 studentë kanë braktisur vendlindjen duke pasur për qëllim studimet e tyre, mirëpo nga mesi i të kthyerve numërojmë vetëm 20.000 deri në 30.000 studentë nga 100.000.

“Ndër shkaqet më themelore që kanë shtyrë talentët e kualifikuar ta braktisin vendlindjen, është mosgjatja e mundësisë për të jetuar në Kinë”, ka bërë të ditur gazeta Kineze në editorialin e saj. Në editorial është theksuar se qeveria Kineze duhet të punojë më shumë në këtë drejtim në mënyrë që t’i inkurajojë emigrantët kinezë të kthehen në shtëpitë e tyre. Shifrat e kinezeve në botë sot arrijnë afro 35 milion, të cilët jetojnë në më shumë se 150 vende të ndryshme të këtij Globi, ka raportuar për gazetën Akademia e Shkencave Shoqërore.

Burimi: ASIAING, Issue 20. viti 2007, f 44.

Përktheu: Feim Dragusha



ÇDO I SHTATI ÇEK PREFERON JETESËN JASHTË FAMILJES SË TIJ

Lidhjet dhe kontaktet ndërmjet familjeve dhe të të afërmeve në Evropë në përgjithësi janë përkeqësuar, e në veçanti në Republikën Çeke, ku shoqëria e saj po troket kambanat e rreziqeve, duke futur dronë se brenda pak viteve do të përsëritet fenomeni i shpërbërjes së shoqërisë.

Të dhënat statistikore çeke raportojnë se numri i atyre që jetojnë vetëm është në rritje dhe tepër shqetësues; 1.35 milion banorë nga numri i përgjithshëm 10 milion jetojnë vetëm apo të vetmuar.

Ekspertet nga Praga për çështje shoqërore flasin se familjet bashkohen vetëm gjatë festave si ajo e vitit të ri, mirëpo këto festa nuk janë të mjaftueshme për t’i vazhduar lidhjet e tyre natyrore. Janë shtuar rastet e shkurorëzimeve, preferimi i jetës së vetmuar, pastaj të vjetrit po ankohen se fëmijët e tyre nuk gjejnë kohë për tu përkujdesur ndaj tyre - citojnë ekspertet nga Praga.

Jergi Tili, mjek për sëmundje psikike thotë se kjo ndodh ngase njerëzit gjithnjë e më shumë po e dëshirojnë jetën në vetmi, pastaj ata nuk po gjejnë shumë kohë ngase janë gjithnjë e më shumë në punë duke u munduar që të mbledhin para për një jetë më të mirë. Po ashtu sipas tij individit nuk gjen liri të plotë se shoku i tij mund t’i ndihmojë atij në zgjedhjen e problemeve të tij, andaj edhe e preferon vetminë.

Situata e krijuar bën që në momentin kur ballafaqohet me të tjerët, ai mundohet t’i shmanget takimeve, shtoi Jergi Tili

Burimi: Al-Jazeera

Përktheu: Ejup Haziri

POEZI

KËRKIM NË HORIZONT

Minushe Daku

Prishtinë

Sa fjale të bukura i thuren lirisë,
sa ëndrra të bukura për dashurinë,
mbi gurë u shkruan të pashlyeshme
fjale për besnikërinë
shumë histori për virtytet e cilësitë e
njerëzimit
shekuj e shekuj

sa kapituj të gjate u përshkruan për
principet e një karakteri të lartë
...shumë fjalëmirë,
shume poet e shkrimtarë të famshëm
thuren vargje për të ëmblën jetë
male të tëra me mësimë.....
njerëz me emër me histori
e na mbërthyen shkrimet
sikur kordonë lidhës mbytin trurin e
njeriut...
njeri...
krijesë...
gabimtar
protagonistë të të njëjtave skena
shekullore
dhe tërë fjalët e njerëzve të mëdhenj
prekin vetëm zemrat e buta

që fatkeqësisht ecin të rrallë
nëpër rrugët e botës kalimtare
kalova vërdallë një pjese të botës....
dhe nuk njoha njeri shembullorë
jo të përkryer jo
ashtu siç do donim ne
jo në kohën tonë
jo në shekujt tanë
atë fat nuk e patëm ne
por të tjerët para nesh
më qan zemra dhe mbërthen loti syrin e
përmallshëm
MUHAMMED të thonë
edhe unë nuk të njoh
atë shoh nëpër librat e vjetër,
në muzetë e shtëpive të mëdha botërore
dëgjoj për ty
qaj për ty
selam të qova ty para Allahut
u luta për ty
sepse shembulli ynë ishte ti
Te lartësoi Krijuesi dhe nuk ka më si ti
të përkryer kemi vetëm të DIJSHMIN

Burimi: <http://poezia-islame.blogspot.com>

PERLA DHE URTËSI

Kështu fliste Hasan el-Basriu:

Pjesa e gjashtë

Hijon nga numri i kaluar

“Gjuha e të mençurit qëndron pas zemrës së tij, nëse dëshiron të flas diç, atëherë i kthehet zemrës së tij, nëse është për të e thotë, e nëse është kundër tij përmbahet dhe nuk flet, kurse tek injoranti zemra e tij është në gjuhën e tij, ai nuk i kthehet zemrës së tij, por ç’i vjen në gjuhë ai e flet atë.”

“O biri i Ademit, shkele tokën me këmben tënde, ngase pas pak ajo do të bëhet varri yt. Ti o biri i Ademit vazhdon ta shkatërrosh moshën tënde që nga koha kur dole nga barku i nënës sate.”

“Besimtarin, koha në kohë e takon në të njëjtën çështje, me të njëjtën fytyrë, me të njëjtën këshillë, ndërsa hipokriti dallon që të ushqehet nga secili popull, dhe shpejton tek çdo furnizim (kudo që e gjen atë).”

“Besimtarit, vepra ia vërteton fjalën e tij, e dukshmja fshehtësinë e tij, dhe prezenca mungimin e tij.”

“Besimtari i mençur është ai, sa herë që Allahu ia shton të mirat e tij, atij i shtohet edhe më frika ndaj Krijuesit të Tij.”

“Besimtari është më i miri me vepra ndër njerëz, dhe më së shumti ndër ata që ka frikë Allahun.”

“Dy gjëra nuk bashkohen asnjëherë: bindja dhe zilia, kurse dy gjëra tjera nuk ndahen asnjëherë: lakmia dhe urrejtja.”

“Ajo çka kërkohet nga ti kur ta takosh vëllain tënd është, ta përshëndetesh me selam, ta thirrsh me emrat më të bukur për të, dhe në vendtubime t’i gësh gjithmonë vend atij.”

“Tre (lloje) njerëz edhe nëse i përgojon (i merr për goje) prapë nuk konsiderohet përgojim: Prijësi tradhtar, ephori-që vazhdimisht thirr të tjerët në eph, dhe hipokriti...”

“O ti që po kërkon nga dynjaja atë që nuk do ta arrish, a po shpreson se do ta arrish nga ahireti atë që nuk po e kërkon?”

“O ti që po kërkon nga dynjaja atë që nuk do ta arrish, a po shpreson se do ta arrish nga ahireti atë që nuk po e kërkon?”

“Besimtarit, vepra ia vërteton fjalën e tij, e dukshmja fshehtësinë e tij, dhe prezenca mungimin e tij.”

Hazhdon në numrin e ardhshëm

Përgatiti: Ejup Haziri

KURIOZITETE

A e dini se, në vitin 1750 në botë jetonin afërsisht 800 milionë njerëz, në vitin 1850 një miliardë më tepër dhe në vitin 1950 edhe një tjetër miliard më tepër. Pastaj u deshën vetëm 50 vjet për tu dyfishuar ky numër, dmth. 6 miliardë?!

A e dini se, breshka mund të ecë me 10 km në orë?!

A dini se, milingonat e ndjejnë tërmetin që më parë dhe dalin menjëherë nga foletë?!

A e dini se, mesatarisht në botë shkohet në shkollë 200 ditë, në SHBA 180 ditë, në Suedi 170 ditë, në Japoni 243 ditë?!

A e dini se, kompjuterët modern janë ndërtuar duke u bazuar në sistemin nervor, por edhe kompjuteri modern nuk i afrohet as nivelit të një zvarritësi?!

A e dini se, në Zelandën e Re ka 4 milionë njerëz dhe 70 milionë dele?!

A e dini se, DNA ka një madhësi prej 1 të mijtat e milimetrit, përbehet prej rreth 200 miliard atome dhe përmban 1 milion faqe njohuri?!

A e dini se, peshqit harrojnë çdo gjë që ndodh vetëm pas 10 minutave?!

A e dini se, një njeri i rritur merr fryme afërsisht 25000 here në ditë?!

Burimi: <http://albania.go.cc/>

POROSI PROFETIKE

“Mëkatet e vogla të bëra ndërmjet dy umreve janë të falura. Kurse për haxhxin e pranuar, nuk ka shpërblim tjetër përveç Xhennetit.”

Muhammedi a.s.

ARGËTIM

PROVO NJOHURITË TUA

1- Cila kaptinë ka zbritur pas kaptinës Ali Imran?

- A- el-Ahzab
- B- el-Bekare
- C- el-Fet'h

2- Sa ishte numri i të vrarëve në luftën e 'Hendekut'?

- A- Tre
- B- Katër
- C- Tetë

3- Cili është kryeqyteti i Ganës?

- A- Nairobi
- B- Darussalam
- C- Ekraa

4- Cili është kryeqyteti i Malajzisë?

- A- Honk Kong
- B- Kuala Lumpur
- C- Islamabad

5- Cili është shteti i themeluar nga Muhammed Alij Xhunah?

- A- Pakistani
- B- Arabia Saudite
- C- Afgansitani

6- Cili shtet nuk është sunduar nga Forcat Kolonialiste Evropiane?

- A- Burma
- B- Malajzia
- C- Tajlanda

7- Sa vite thirri Muhammedi a.s. fshehurazi në besim?

- A- 2 vite
- B- 3 vite
- C- 5 vite

8- Sa është numri i qelizave të trupit?

- A- 1 biliardë
- B- 30 biliardë
- C- 70 biliardë

9- Sa vite zgjati zbritja e Kur'anit?

- A- 23 vite
- B- 25 vite
- C- 29 vite

10- Cila është sëmundja e diturisë?

- A- Dembelia
- B- Gjumi
- C- Injoranca/xehli

Përgatiti: **Ejup Haziri**

Përgjigjet e sakta:

1. el-Ahzab. 2. Katër. 3. Ekraa . 4. Kuala Lumpur. 5. Pakistani. 6. Tajlanda. 7. 3 vite. 8. 30 biliardë. 9. 23 vite. 10. Injoranca/xehli .

Përveç shkrimeve të studentëve nga Brunei Darussalam, revista "Studenti", duke parë si të domosdoshëm kooperimin e lexuesve me studentët në Brunei, shfaq edhe letrat, shkrimet dhe opinionet e lexuesve që dërgohen në revistën 'Studenti'. Për t'u botuar shkrimet apo opinionet e juaja në revistën elektronike 'Studenti', duhet përmbushur kriteret vijuese: shkrimi mos të kaloj më shumë se dy faqe të formatit A4, spejsingu 1.0, shkrimi të mos jetë i publikuar diku më parë, si dhe emri dhe mbiemri i autorit apo përkthyesit duke ia bashkangjitur edhe e-mailin e juaj. Mos harroni se opinionet e juaja do të jenë të mirëseardhura.

Ju mos nguroni të shprehni talentin tuaj përmes revistës 'studenti', dhe ne do ta botojmë atë, gjithashtu edhe kritikën, vërejtjet dhe sugjerimet tuaja janë shumë të mirëpritura dhe të mirëseardhura për ne.

E - m a i l :
studenti_brunei@hotmail.com
brunei_student@hotmail.com

webfaqja e revistës:
www.studenti.co.nr

Letrat e lexuesve

Përtej errësirës

Sa herë valët e detit më kanë hedhur në breg pa mëshirë dhe unë përsëri me ëndje zhytesha në to. Një moment i kaluar pa to, mendoja se kishte shkuar dëm në jetën time e nuk e kuptoja se ky det i fuqishëm dita ditës më mbyllte nga një pore të jetës. Isha zhytur në ato valë saqë dhe shpirti me pushonte në to.

Por një ditë si duket deti kishte vendosur me ngulm të më dëboi nga shtrati i tij përgjithmonë. Me hodhi në breg, por kësaj here u ula të bisedoj me veten gjë që se kisha bërë kurrë më parë. Dhe jo rrallë herë përsërita me vete fjalët:

A thua kush nënshtroi shiun të na njomë, kush nënshtroi diellin të na ndriçojë, kush nënshtroi çdo gjë për rreth nesh për ne. Dhe kush nuk kishte mbarim, mendova me vete për kohën e shkuar dhe vendosa të pendohesha edhe pse këtë nuk dija si ta bëja, mendova të thërrisja çastet njërin nga ato qaste që më kishte ikur pa e shfrytëzuar.

"O çast të lutem shumë kthehu se jam penduar e dua të përdorë për të mirë." Ahhh gjë që nuk bëhet ma ktheu çasti, unë mund vetëm të të këshilloj: Mundohu që pas sodit të bësh punë të ndershme se vetëm në këtë mënyrë mund ta shlyesh të kaluarën.

Dhe që nga sot sytë e mi panë dritën. Braktisa labirintet e jetës që më kishte njoftuar epshi me to, braktisa edhe ato valë të cilat më parë më kishin puthur çdo qelizë, braktisa edhe...

Tani jetoj krenare me Kur'an dhe çdo pyetje që has gjatë jetës përgjigjen e gjej në të, derisa dikur këtë përgjigje e gjeja në shishe e panumërta të konjakut, në dëfrime e gjëra pa kurrfarë vlere.

Meritë Basholli
Gjimnazi 'Eqrem Çabej' Vushtrri
Klasa XIII₁

An aerial night photograph of a large stadium, likely the Prishtina Stadium, filled with a crowd of people. The stadium is illuminated, and the surrounding city lights are visible in the background.

Revista 'Studenti' ju uron
festën e Kurban Bajramit.

Me fat Bajrami!

www.studenti.co.nr